

M E S H A
E
S H Ě N J A N G O J A R T I T

P Ě R K T H Y E R S H Q I P

N G A

E M Z. P A L S C H I R O I

B O T U A R M E K U I D E S I N E

P R O F. Z E F S C H I R O I T

P A L E R M O

1964

LITURGIA
DI
S. GIOVANNI CRISOSTOMO

TRADOTTA IN ALBANESE

DA

MONS. PAOLO SCHIRO'

A CURA DEL

PROF. ZEF SCHIRO'

PALERMO

1964



PAL SCHIRO-I

Me paret te mbledhura nga nje grup atdhetarësh ne mergim botojem kete xhevajir te gjuhes arbreshe. Dhuruesit kane dashur ne kete menyre me nderue fe-tyren fisnike e atdhetare te Emz. Pal Schiro-it auktor te ketij libri, edhe ti bejen te njohur albanologeve punimin e tij te mbrame.

Pal Schiro-i lindi ne Horen e Arbereshevet (Piana degli Albanesi) me 25 Nendor 1866.

Mbasi mbaroi shkollat fillore ne vendin e lindjes studioi ne Seminarin Arberesh te Palermos, duke u treguar nje nga xensit me te shqyar e me te zotet, siç na e dishmojen diftesat shkollore qe kemi ne dore. Pati shoke shkolle poetin Zef Schirò dhe vellan e tij Gijnin e bashke me ta ushqente nje dashuri e madhe per gjuhen shqipe e per traditat kombetare. Ne kete tempull te shejte te kultures sone kombetare e fetare ata mesuan te dashurojen atdheun e te Parevet dhe te punojen per pamvarsin e tij.

Qe kur ishte student, mbas shembullit te Dhimiter Kamardes, per te cilin tregoi gjithmone nje nderim i veçante, u muarre me studhimin e gjuhes shqipe siç na e dishmojen deftere e shkrime te shumta gjuhesore te dialeris se tij.

Esht per te ven re se ne nje kohe kur Pal Schiro-i ishte ne Seminar, Dhimiter Kamarda ishte shume i njohur prej albanologeve e prej patrioteve shqiptare. Kamarda vdiq ne 1882 kur Pal Schiroi ishte dial giashtem-bedhjetvjeçare.

U dorezua prift ne Kishen e Madhe te Shen Mitrit ne Horen e Arbereshevet me 8 Maj 1892 e per zotesin e tij te ralle, mbasi ndenji per nje kohe te shkurter ne vend-lindjen, u thirre te mesoj gjuhe e literature greke ma perpara ne Seminarin e Triventos e me vone ne ate te Bitontos (Bari).

Ketu u dallua per dijen e urtesin e tij aqe sa me 11 fruer 1904 prej Selis se Shejte u emrua Ipeshkev i Arbereshevet te Sicilise e me 20 Mars te te njejtit vjet u dorezua ne prani te nji numeri te mathe perfaqesuesish Arbereshe e Shqiptare.

Nder perfaqesuesit te Arbereshevet shquhej poeti Zef Schirò.

Shugurimi i tij si Dhespot u prit prej Arbereshevet si nje ngjarie historike me rendesi dhe e tille duhet gjykuar po te marrim para sysh gjendien e vajtushme ne te cilen ishen katandisur kolonite arbreshe te Sicilise. Ne Mezzoiuso prej kohe nuk flitej me shqip dhe ne Palaco Adriano pake vete e flisien ende dhe ne kolonite e tjera perdorimi i shqipes ishte braktisur prej kishëve ku per disa sherbesa fetare perveç greqishtes, perdorej italishtia ose dialekti i Sicilise. Priftrat arbreshe e kishen per turpe me u vesh ndryshe nga priftrat latine e nuk perdorshin me as kalimafin mos me u diktue si priftra arbreshe.

Dashuria e besnikeria ndaj gjuhes, traditave, zako-

neve kombetare ishen duke e zhdukur, dhe ne Horen e Arbreshevet, qe kishte qene gjithmone kryeqiteti shpirtoror i Arbreshevet te Sicilise, ishen shume pakesuar.

Por shpresat e paris se Hores dhe te sa vetave kishen ende ne zemer pasurin e shejte te trazhguar prej te parrvet ishen te mbeshtetura ke ipeshkevi i ri dhe ky nuk i rrejti.

Fletorja « *Flamuri i Shqiperis* » (15 Prill 1904) shkruante: « Gjithe Shqiptaret e Sicilise e gjithte te huajte qe e njohine dhe e nderojne jane te gezuat per se tepri qe Selja e Shejte e ka zgjedhur nder priftrat e tje-re si I peshkev dhe si Rektor i Seminarit kombetar te Palermos ».

Si rektor i Seminarit, shkruan Petrotta, « dekoj ne zemerem e xensevet arbreshe nje dashuri te madhe per gjuhen e per zakonet e Ateravet jo per nje fanatisme te kote, po per rilindien shpirtorore, politike e fetare te popullit shqiptar ».

Ne ket grup xensish shquhet prej te tjerevet vete Petrotta i cili u njoh ma vone si albanoge i permendur.

Me spenzimet e veta botoj prej 25 te shkurtit 1912 deri ne 15 Maj 1915 « *Fialen e t'in'Zoti* » dhe ne kete menyre shtyri edhe nje here shqipen brenda mu-revet te Seminarit, te kishavet, te shtepivet.

« *Fiala e t'in'Zoti* » arriti ne vatren e cedo shtepie arbreshe. Gjithmone me paret e vet zemeloj ne Semi-nar nje shtipekronje arbreshe e cila jo vetem botonte « *Fialen e t'in'Zoti* » po edhe botime te tjera te vogla qe u shperdajshin falas ne kishat te kolonivet arbreshe. *Fiala e t'in'Zoti* nuk qe vetem nje fletushke e vogel fe-

tare per dite te Djellia por edhe e sidomos nje shkolle e nje vater atdhetarismì per djalerin arbreshe, nje leme studimi e nje farke patriotesh arbreshe.

Kishat e Hores dhe te kolonivet e tjera kumbuan edhe njehere me tingujte e embel te gjuhes arbenore.

Fiala e t'in'Zoti sado e vogel e me veshje te pervujte terhoqi vrejten e patrioteve e te dijetarevet te tere botes. Albanologet me ne ze te asaj kohe kane gene te paret qe priten me interisin me te madhe shkencor botimin e saje; midis disave permendin N. Yokl, Geitler, Guys e Holger Pedersen.

Keta te gjithë ishin aqe te interesuar ne botimin e saje sa nuk dojshin me humb asnje numer.

Sot koleksioni i saje gjykohet si nje nga dokumentat gjuhesor me me rendesi per studimin e shqipes.

Ka gene per botimin e Fiales e t'in'Zoti qe Pal Schiroi pati nje korispondence te dendure e te vazhdueshme me albanologet e me atdhetaret te asaj kohe, Lef Nosi, Kristo Luarasi, Midhat Frasheri, Shtiefen Gieçovi, Gjergj Fishta, Lazer Mjedha e sa e sa te tjere te cilet çmojshin dijen e atdhetarismen e tij.

Pal Schiroi nuk qe vetem nje apostull shqiptarizmi por edhe nje albanologe i çquare qe na la studime gjuhesore me shum rendesi ende te pa botuara. Pal Schiroi esht i njohur nga lavruesit e gjuhes shqipe si zbulonjesi i librit ma te vjeter shqip, meshari i Dom Gjon Buzukut, botuar ne 1555 qe nuk u njihete prej shtypit para vjetit 1909.

Ka gene pikerisht mbas kerkesavet te tija qe dijetaret mesuan se si Emz. Gjon Kazazi, shqiptar prej Gja-

kove e Arqipeshkev i Shkupit gjeti librin e Buzukut dhe i shkrojti At Gjergj Guzetes, themeluesit te Seminarit Kombetar te Palermos.

Mbas ketireve te dhenave e mbas kerkesavet te bera Pal Schiroi gjeti librin e Buzukut ne mes te librave te pa kataloguara te Bibliotekes Vatikane, pikerisht copen qe kishte gjetur Em. Kazazi ne Biblioteken e Propaganda Fides, me njehere me gezim te madhe ja lajmeroj gjithe shqitarevet me ane te shtypit.

E para fletore qe mori lajmin gazmore dhe e botoi ka qene Djelli (V. II, n. 51) qe me 18-3-1910 nen ketij titulli: « Ma i vjeteri shkronjes shqiptar i njohur » boton: « Ne numer 41 te Djellit thosha (Faik Konica) qe i pari liber shqip i njohur esht « Pasqyra e rrefimit » (Speculum confessionis) e Pjeter Budit e shtypur ne 1621 ne Rome. Nje exemplar i ketij libri ndodhet ne Biblioteque Mazarin te Parizit, dhe jam i pari qe e zbulova, sic shkruaja te « Albania » qemoti se perpara meje albanologet besojen qe me i vjeteri liber shqip ish Fialori latinisht-shqip i Frano Bardhit (Roma 1635).

Me nji gas te thelle dhe qe nuk refehet, mora nje letre nga Hiresia e Tij Monsignor Paolo Schirói, peshkopi titular i Bendes, drektor i Seminarit Greko-Shqiptar (d.m.th. i Shqiptarevet te ritit grek) ne Palermo dhe delegat per kolonit shqiptare te Sicilise. I shkelqyeri atdhetar me defton lajthimin qe beja duke kujtuar qe libri ma i vjeter i njohur ne gjuhe t'one dolli 1621. Hiresia e Tij njuh libra shqip shume me te vjetra dhe na shpie gjer 1555. Ja letra e Mons. Schiroit; e shtypim fiale pas fiale; s'ka nevoje per perkthim, se djalekti i Shqiptarevet te Sicilise ndryshon pak nga yni ».

Ketu fletoria boton tere letren e Emz. Schiroit qe flet mbi zbulimin e Mesharit te Buzukut dhe mbi botimin e Doktrines se Lukes Matranga. Mbas letres gazeta shton: « Besojme se kjo leter ka per te gezuar gjithë atdhetaret, si ka per te interesuar edhe gjithë albanologet. Gjer me sot, rekordin e çfaqies se librit shqip ma te vjeter e kish Faik be' Konitza, pasketaj do t'a kete i çkelqyeri peshkop i Shqiptareve te Sicilise ».

I mbetet pra Pal Schiroit merita e madhe te ket zbuluar librin ma te vjeter te gjuhes sone, mesharin e Dom Gjon Buzukut duke ndjekur gjurmat te nji letre te Kazazit shkruar ne 1740 d.m.th. 269 vjete me para.

Per albanologjin e per historin e Letersis shqipe zbulimi i ktij monumenti te gjuhes sone ka qene nje nga ngjariet me me rendesi. Por Pal Schiroi jo vetem ka qene zbulesi i Mesharit te Buzukut por ka qene edhe me i madhi studiues i ktij dokumenti te rendesishem te gjuhes sone.

Poeti Zef Schiró ne fjalimin akademik mbajtur ne 1918 e botuar ne Anuarin e Institutit Lindor te Napolit (1917 - 1918) thot: « Fatin e merituar te zbuloj ne Rome librin ne fjale e pat peshkopi i Shqiptarevet te Sicilise Emz. Pal Schiroi, lavrues i ngullshem i gjuhes amtare.

Te ktij dokumenti albanologu i math la nje studim shum te rendesishem me kete titull: « Tekstet biblike ne gjuhe shqipe te Dom. Gjon Buzukut te radhitura me perkthim fjale mbas fjale italisht e me shenime ».

Ky doreshkrim esht, mbas gjykimit te sa dijetareve qe e kane pare, nje kontribut nga me te rendesishmit studimit te gjuhes shqipe.

Ne kete veper monumentale, kryer mbas tridhjete vjeteve pune, auktori na paraqet ne interpretimin fonetik te folurit e Buzukut d.m.th. shqipen e 1555-ses dhe kendonjesit libri i qemoçem i shfaqet si nje liber i kohes se tashme duke pasur mundesin te shioje shprehjet e shqipes se vjeter te XVI-it shekull.

Çka ben shum te vlefsheme e te rendesisheme kete veper jane shenimet kritike me te cilat esht pajisur.

Gjuha e Buzukut esht studiuar ne te gjitha trajtat e saja ne krahasim me tekstet e tjera te vjetra qe auktori njihite ma se miri.

Per te marre veshe se si Pal Schiroi njihite tekstet e vjetra duhet dijtur se ai kishte kataloguar te gjitha trajtat te perdorura (veç e veç) nga Budhi, nga Bardhi, nga Bogdani, nga Matranga dhe nga Buzuku ne menyre qe kurdohere mund te krahasonte fjalet te ketyre teksteve edhe ne gjitha trajtat gramatikore. Shenimet e tekstit jane perpillue mbas kesaj pune durimi.

Mjafton me vezhgue nje faqe te vetme te ketyre shenimeve per te marre veshe sa e rendesishme esht kjo veper e Pal Schiroit.

Studimi i gjuhes shqipe mbas botimit te ksaj vepre ka me pas po dyshim nje shtytie me rendesi.

Nje lavrues shum i njohur i gjuhes shqipe, Aleksander Xhuvani, duke pasur ne dore doreshkrimin ne shtepi teme ne Shqiperi me tha pikerisht keto fjale: « Asnje shqiptar dhe asnji i huaj studioi kurr gjuhen shqipe kaqe thellesisht dhe me aqe dashuri e kembengulje ».

Mustafa Kruja pak kohe ma perpara se me vdeke me shkruante: « Puna qe ka bere i ndyeri ungi jua,

Imz. Schiroi, me vepren e Buzukut, se pari duke e nxierre ne drite dhe pastai duke e punuar esht nje aso punesh qe nuk blehen me para. Emri i tij do te mbetet i gdhendur ne kujtesen e gjithë atyre qe kane per t'u marre me letersin e filologjin shqipe ».

Nje tjeter lavrues i pa lodheshem i gjuhes shqipe Karl Gurakuqi ne nje artikull mbi Pal Schiroin shkruan: « Pal Schiroi kishte ba studime t'imta mbi librin, e kishte shtrydhe nga te kater anet dhe kishte nxjerre prej tij nje lande shume te vlefshme per albanologjin » dhe duke pershkruar personin e Pal Schiroit qe ka njohur personalisht shkruan: « Fytyre e nderueshme Emzot Schiroi: Mjekrra e plote, krejt e bardhe, nji pal sy te gjalle, qe pas syzave trathtojshin nje inteligjence te shqueme, zani i trashe, trupi i bashem, i jipshin persones se tij nje pamje me te vertete patriarkore. Ndonse i kishte kapercye 74 vietet, kishte ende kjartesin e mendjes, zotsin e punes, madje edhe entusiasmin e optimizmen e punes; ishte ende i shkathte me dore te sigurte, me gjykime te kjarta e me mbamendje te çuditeshme ».

Pervec studimit mbi Buzukun, qe esht vepra e tij me me rendesi dhe qe i ka kushtuar me se tridhiete vjete pune, e tija esht nje veper tjeter, sado e pa plotesuar, nje gramatike krahasuese ne te cilen ai nuk kursen dijen e tij te madhe mbi gjuhen.

Vepra e tij e fundit ka qene ky perkthim i Liturgjis se Shen Jan Gojartit, qe ai shkruajti ne vjetet e mbrame te jetes se tij me eksperjencen e fituar mbas kaqe vjeteve studimi te gjuhes arbreshe.

Ai njihite liturgjine shqipe e perdorun nga kisha autogefale dhe njihite perkthimet e tjera ma te perparshme por nuk i gjykonte te pershtateshme per kolonit arbreshe.

Pra ai u mundua qe te krioj diçka qe ti afrohej me shum embelsis shprehese te gjuhes se Gojartit. Me kete qellim ai perktheu liturgjin e shen Janit me diturin e nji dijetari e me nxehtesin e nji shejti.

Duke perdorur si brum kryesor gjuhen arbreshe (mbasi kjo esht gjuha me arkaike dhe qe ai zotnonte ma mire se kush) e duke shfrytezuar njohurit e thella mbi auktoret e vjeter e sidomos te Buzukut sajoj nje gjuhe fisnike per lashtesin e saje arkaike dhe e paster pse e qerueme nga barbarismat te kota qe shum here gjinden ne prosen tone ma te mire. Munt te themi se ne kete liber gjejem gjuhen e te parevet tane ringjallur me penden e Pal Schiroit i cili dijeti ta beje te pershtateshme mendimevet te larta e mistike te liturgjise.

Priftrat me te vjeter te Hores e mbajen ment kur duke shetitur me ta ne mbremje jashta qytetit i kendonte kete perkthim qe mbylli, si nje lutje, mundimet te nji njeriu aqe i dishem sa i drejte.

Mbasi Pal Schiroi nuk qe vetem nje apostull e nje dijetar; ai mbi te gjitha ka qene nje njeri i drejte e me nje karakter te pa perkulshem.

Kur nuk i uli shpinen kujt, as te pasurve as te fuqishmeve, ka qene shqiptar nga me fisniket edhe ne karakterin e tij, ndera e burrnia pasqyrojshin ne te vertytet e kombit tone te lashte.

Demokrat i bindur, nuk shkoj mbas parimeve rrenacake e dokrave politike te kohes se tij, aq sa ne vjetet

e mbrame mbeti i vetem me ngushellimin e libravet shqipe e te studimevet gjuhesore qe ai deshi mbi te gjitha.

Vdiq me 12 Shtator 1941 ne Horen e Arbreshevet e cila munt te krenohet te ket lindur nje nga Arbreshet me te medhenje dhe nje nga albanologet me ne ze.

ZEF SCHIROI

Pak fjale mbi tekstin.

Per arsye te saktesis shkencore, mbasi libri i esht kushtuar studionjesvet te gjuhes, menduam te botojem tekstin njashtu siç e ka shkruar auktori edhe atje ku e njejta fjale ka dy perkthime mbasi nuk dime se cila do qe trajta e zgjedhur nga auktori kur ta vente ne shtyp. Kemi menduar me ba keshtu mbasi teksti kuptohet fare mire sado ka pake ndryshime midis alfabetit te perdorur e alfabetit zyrtar te shqipes. I vetmi ndryshim per te she nuar esht perdorimi i e te pa theksuar si e pazane keshtu si e ka perdorur Faik Konica ne Albania, te diftongut ae si e pazane hundore e gjate dhe ë si e pazane hundore e shkurter.

Con i mezzi forniti espressamente da un gruppo di patrioti albanesi in esilio ci è consentito di pubblicare questo gioiello della lingua albanese.

Essi hanno così voluto onorare la grande e nobile figura di Mons. Paolo Schirò che ne è l'autore e nello stesso tempo fare noto agli Albanesi e agli studiosi l'ultimo lavoro di questo grande siculo-albanese.

Paolo Schirò nacque a Piana degli Albanesi il 25 novembre del 1866. (Fra due anni ricorrerà quindi il centenario della sua nascita e il 25^o della sua morte).

Dopo aver frequentato le scuole elementari del paese nativo, studiò nel seminario albanese di Palermo, di cui fu uno dei più bravi alunni, come ce lo testimoniano i numerosi attestati di profitto di cui siamo in possesso e specialmente nelle lettere latine e greche.

Ebbe compagni di scuola il poeta Giuseppe Schirò, e il di lui fratello Giovanni, con i quali condivise il grande amore per la lingua albanese e per le tradizioni avite. In quel sacro tempio della cultura nazionale e religiosa albanese essi appresero ad amare l'Albania e a lavorare per la sua indipendenza. Già da studente egli, su l'esempio di Demetrio Camarda, di cui mostrò sempre grande ammirazione, si diede allo studio della lingua albanese, come ci dimostrano numerosi quaderni e scritti della sua prima età.

E' da ricordare che al tempo in cui Paolo Schirò era giovane studente, il Camarda era notissimo agli Albanesi e agli studiosi, infatti egli morì nel 1882 quando Paolo Schirò era sedicenne.

Consacrato sacerdote nella Cattedrale di S. Demetrio l'8 maggio del 1892, per le sue doti e per la sua preparazione,

dopo una breve parentesi di permanenza a Piana, fu chiamato ad insegnare lettere greche prima nel seminario di Trivento e poi in quello di Bitonto (Bari). Ivi si distinse per le sue virtù morali e per la sua dottrina, tanto che l'11 febbraio 1904 vi ricevette, dalla Santa Sede, la nomina a Vescovo degli Albanesi di Sicilia, e il 20 marzo dello stesso anno fu consacrato a Bitonto alla presenza di una numerosa rappresentanza di italo-albanesi e di albanesi d'Albania. Tra i molti rappresentanti delle colonie vi era anche il poeta Giuseppe Schirò.

La sua consacrazione a Vescovo fu salutata dagli Albanesi di Sicilia come un avvenimento storico e tale lo fu se si considerano le condizioni pietose di abbandono in cui si erano ridotte le colonie albanesi di Sicilia.

A Mezzojuso da tempo non si parlava più l'albanese, a Palazzo Adriano pochissimi lo parlavano ancora e nelle altre colonie ne era scomparso l'uso nelle chiese dove tutte le pratiche religiose extra-liturgiche si facevano in italiano o addirittura in dialetto siciliano. I preti si vergognavano di andare vestiti diversamente dai latini e non portavano più neanche il calimafio perchè non fossero riconosciuti quali preti albanesi.

L'amore e l'attaccamento alla lingua, alle tradizioni avite, ai costumi nazionali in alcune colonie era scomparso e nella stessa Piana era fortemente in declino, anche se sacerdoti coraggiosi come Papas Damiano Carnesi e Papas Giuseppe Musacchia cercavano di arginare il totale sfaldamento della colonia più grande della Sicilia, che era stata sempre la capitale morale dei siculo-albanesi.

Ma le speranze dei migliori di Piana e di quanti avevano ancora a cuore il sacro patrimonio lasciatoci in retaggio dai nostri avi erano riposte nel nuovo Vescovo di Sicilia ed egli non li deluse. Il giornale « Flamuri i Shqipëris » del 15 aprile 1904 scriveva: « Tutti gli Albanesi della Sicilia e tutti gli stranieri che lo conoscono, lo amano e lo venerano sono oltremodo lieti che la S. Sede l'abbia scelto, fra gli altri sacerdoti,

quale Vescovo e quale rettore del seminario nazionale di Palermo ».

Come rettore di detto seminario per più di venti anni « istillò, come dice il Petrotta, nell'animo dei giovani studenti siculo-albanesi un forte amore alla lingua e alle avite tradizioni non per vano fanatismo, ma per un cosciente apostolato a favore della rigenerazione morale, politica e religiosa del popolo albanese ».

E di questo stuolo dei suoi discepoli possiamo, primo fra tutti, annoverare il citato dotto albanologo Prof. G. Petrotta e tanti altri sacerdoti e professionisti di Piana e delle altre colonie che da lui impararono la lingua albanese, che egli con tanto amore e tanta tenacia aveva portato di nuovo tra le mura del seminario e delle Chiese di Piana. Infatti egli riuscì a ripristinare l'uso della lingua albanese nelle chiese e fu dietro il suo luminoso esempio che il Petrotta, il Petta e numerosi altri ancora continuarono il suo apostolato religioso e patriottico. Fu lui che pubblicò a sue spese dal 1912 al 1915 il *FIALA E T'IN'ZOTI* che per il primo anno fu scritto interamente da lui fino a quando non ebbe qualche collaboratore quale fu il Gaetano Petrotta.

Egli fondò in Seminario a sue spese una tipografia albanese che non solo stampò il *FIALA E T'IN'ZOTI* ma numerose altre piccole pubblicazioni albanesi, in gran parte religiose, che come il *Fiala* e *t'in'Zoti* egli faceva distribuire gratuitamente nelle chiese delle colonie.

Il *FIALA E T'IN'ZOTI* non fu soltanto un giornaleto religioso della Domenica, ma anche e soprattutto una scuola e un focolare di patriottismo di cui fecero parte numerosi giovani. Il *FIALA E T'IN'ZOTI* fu una palestra di studio e una fucina di entusiasti italo-albanesi.

Le chiese delle colonie albanesi di Sicilia risuonarono di nuovo dei dolci accenti del nostro idioma.

Il *FIALA E T'IN'ZOTI*, pur nella sua modestia, attirò l'attenzione e dei patrioti e degli studiosi di tutto il mondo.

I più grandi albanologi del tempo furono i primi ad accoglierne con grande interesse scientifico la pubblicazione, così Norbert Jokl, così il Geitle, così il Guys e Holger Pedersen e che tanto tenevano a non perderne neanche un numero.

Fu proprio a causa della pubblicazione del FIALA E T'IN'ZOTI che egli ebbe una intensa corrispondenza con gli studiosi e con i patrioti albanesi di quel tempo, Kristo Luarasi, Lumo Skendo, Lef Nosi, Don Shtjefen Gjeçovi, Gjergj Fishta, Lazër Mjeda e tanti e tanti altri che ne ammirarono la dottrina e il patriottismo.

Paolo Schirò non fu soltanto un apostolo, fu anche un grande albanologo che ci lasciò importantissimi lavori linguistici ancora inediti. Egli è noto soprattutto per aver scoperto e studiato profondamente il più antico libro stampato in albanese, il Messale di Don Gjon Buzuku del 1555.

Infatti egli fu il vero scopritore del Buzuku, di cui gli studiosi e la stampa albanese fino al 1909 non ne conoscevano l'esistenza.

Fu appunto dietro le sue ricerche che gli studiosi seppero la storia del suo ritrovamento da parte di Mons. D. Giovanni Battista Casasi, albanese di Giacova ed Arcivescovo di Scopia nel 1740 e della comunicazione che questi ne fece al Padre Giorgio Guzzetta. Dietro queste notizie lo Schirò fu il primo a ritrovarlo nella Biblioteca Vaticana tra i libri non catalogati e subito con grande gioia ne diede l'annuncio a tutti gli Albanesi nel mondo a mezzo della stampa.

Il primo a riceverne la notizia e a pubblicarla fu il DIELLI (Anno II n. 51) del 18-3-1910 sotto il titolo « Il più antico scrittore albanese conosciuto » scrive quanto segue: « Nel n. 41 di DIELLI dicevo (è Faik Konica che scrive) che il primo scrittore albanese conosciuto è PASQYRA E RËFIMIT (Speculum confessionis) di Pietro Budi, stampato nel 1621 a Roma 1) Uno esemplare di questo libro si trova nella Biblioteca Mazarino di Parigi, e sono il primo che l'ho scoperto come scrivevo in « Albania », da tempo, perchè prima di me gli albanologi cre-

devano che il più antico libro albanese fosse il vocabolario latino - epirotico di Franco Bardhi (Roma 1635). Con gioia profonda e indicibile, ho ricevuto una lettera di S.E. Mons. Paolo Schirò, vescovo titolare di Benda, rettore del Seminario albanese di Palermo. L'illustre patriota mi dimostra l'errore che facevo dicendo che il libro più antico conosciuto nella lingua nostra uscì nel 1621. S.E. conosce invece libri molto più antichi e ci porta fino al 1555 ». Qui il giornale riporta la lettera dello Schirò che parla appunto del ritrovamento del Messale del Buzuku e della esistenza della Dottrina di Luca Matranga. Ho voluto ricordare quanto sopra per ben chiarire che se è vero che il Casasi ne comunicò privatamente il ritrovamento del Messale presso la Propaganda Fide al nostro Padre Giorgio Guzzetta, rimane sempre allo Schirò il merito grande di averlo scoperto fra i libri sconosciuti della Biblioteca vaticana dietro la lieve traccia della comunicazione del Casasi che risaliva al 1740 cioè a 269 anni prima. Rimane quindi Mons. Paolo Schirò il vero scopritore del Messale del Buzuku, come ne fu il suo più grande studioso, come diremo.

Tutti i giornali del tempo ne annunziarono la scoperta come il Tomori del 30 giugno 1910, così Liria del 19 giugno 1910 ed altri ancora.

Il Prof. Giuseppe Schirò nel discorso accademico tenuto nel 1918 e riportato dall'annuario dell'Istituto Orientale di Napoli (1917-1918) dice: « La fortuna ben meritata di ritrovare a Roma il libro di cui trattasi, l'ha avuto l'attuale vescovo degli Albanesi di Sicilia, Mons. D. Paolo Schirò, cultore appassionato della lingua dei padri ».

Di questo importantissimo documento linguistico il grande albanologo lasciò uno studio profondissimo intitolato « I testi biblici in lingua albanese di dom Gjom Buzuku, messi in ordine, con traduzione letterale italiana e note ». Questo manoscritto è a giudizio di quanti studiosi ne hanno preso visione un importantissimo contributo allo studio della lingua

albanese. In questo studio, maturato da varie decine di anni di lavoro, l'autore ci presenta nella sua interpretazione fonetica il parlare del Buzuku, cioè l'albanese del 1555 e al lettore il vecchio codice è presentato come un libro contemporaneo di cui può gustare le espressioni di quel vetusto albanese del XVI secolo.

Quello che poi ispira profonda ammirazione è che il libro, nelle sue vaste e ricche note, è sviscerato in tutte le sue forme e messo in paragone dei testi antichi che l'autore conosceva in maniera veramente minuziosa. Basta leggere una sola pagina di queste note per rendersi conto della grande importanza dello studio dello Schirò. Molti problemi di fonologia, di morfologia e di sintassi ne sono talmente illuminati che soltanto la costanza certosina e la perizia magistrale di Paolo Schirò potevano risolvere. Lo studio della lingua albanese con questa opera riceverà senza dubbio un nuovo grande impulso. Un noto studioso albanese, Aleksandër Xhuvani ebbe a dirmi, dopo aver dato uno sguardo al manoscritto: «Nessun albanese come nessuno straniero studiò mai la nostra lingua così profondamente e minuziosamente e con così grande amore e costanza ».

Mustafa Kruja poco tempo prima di morire mi scriveva testualmente: « Il lavoro fatto dal compianto vostro zio, Mons. Paolo Schirò, con l'opera sul Buzuku, portandolo prima alla luce e poi studiandolo è uno di quei lavori per i quali non vi può essere compenso. Il suo nome rimarrà scolpito nella mente di quanti si occuperanno di letteratura e di filologia albanese, ecc. ».

Questa è l'opera sua più importante, ma di lui rimane molto importante anche una grammatica incompiuta, in cui sono profuse a grandi mani le sue profonde conoscenze degli antichi autori.

Ultimo lavoro per ordine di tempo e non per importanza fu questa traduzione della Liturgia di S. Giovanni Crisostomo, che egli scrisse nella piena maturità dei suoi anni,

e con la grande esperienza e dottrina che aveva acquistato in tanti anni di studio della lingua albanese.

Egli che pur conosceva la liturgia in uso presso la chiesa autocefala albanese e le altre traduzioni precedenti, non la trovava adatta al suo compito soprattutto per le colonie albanesi d'Italia.

Egli volle creare qualche cosa di più elevato e di più degno della Liturgia, qualche cosa che si avvicinasse ancor più alla dolcezza espressiva della lingua usata dal Crisostomo.

Con questo intento egli tradusse la liturgia con la scienza di un dotto e con il fervore di un santo.

Prendendo come sfondo linguistico l'albanese delle colonie (essendo questo l'albanese più arcaico e che egli conosceva alla perfezione) e facendo tesoro della conoscenza profonda del Buzuku, del Budi, del Bogdani e del Matranga riuscì a creare una lingua aurea degna dello scopo a cui era destinata. In questo breve lavoro infatti noi troviamo usata una lingua albanese, nobile per la sua vetustà arcaica e spoglia da quegli inutili e superflui barbarismi di cui è infiorata talvolta la nostra migliore prosa.

Possiamo ben dire che in questo libro noi troviamo la lingua dei nostri padri tornare viva in bocca dello Schirò, che la sa plasmare e adattare mirabilmente agli elevati concetti della liturgia.

Leggere questa prosa pervasa da mistica poesia religiosa è veramente un godimento spirituale.

I nostri papas più vecchi, che lo hanno avuto grande maestro, ricordano quando a passeggio la sera rileggeva loro questo lavoro che chiuse come una preghiera le fatiche di un dotto e di un giusto. Perchè Paolo Schirò non fu soltanto un dotto, egli fu soprattutto un grande uomo di carattere. Egli non piegò mai la schiena ai ricchi e ai potenti per averne le grazie e i favori deflettendo dai suoi principi. Fu un precursore delle moderne correnti democratiche e così si spiega la sua amicizia con i fondatori di queste correnti e il grande rispetto che questi ne avevano.

A questi principi egli fu sempre fedele anche quando ciò gli fu di nocumento personale ed infatti negli ultimi anni rimase solo con i suoi libri e con i suoi studi di albanese a lui tanto cari.

La morte lo colse il 12 settembre del 1941 nella sua diletta Piana che può andare orgogliosa di avere dato i natali a uno dei più grandi italo-albanesi.

GIUSEPPE SCHIRÒ

BREVI CENNI SUL TESTO

Per ragioni di esattezza, poichè questa pubblicazione è dedicata agli studiosi della lingua, abbiamo creduto di lasciare inalterato il testo albanese come l'ha scritto l'autore anche dove una stessa parola ha due diverse scritture e non sappiamo quale sarebbe stata scelta nella stesura definitiva del testo. Abbiamo ritenuto di fare così perchè il testo è perfettamente comprensibile nonostante le poche differenze dell'alfabeto usati da quello ufficiale.

L'unica differenza rimarchevole l'uso della e non accentata come e muta così come già aveva fatto il Faik Konica sull'« Albania », e del dittongo œ come muta nasale, lunga e della ë come muta nasale breve.

**MÉSHA E PÈRENDISHMÈ
E ATIT T'ENE NE MÈS TE SHEJTERAVÈT
SHEN JAN GOJARTIT**

PERGATITJA

Priſti è diakeri: Ijme afer, o Pèrendi, lipisi per mua sè jam i mekatruam.

Diak.: Bèko, urata jotè.

Priſti (nde kshill): Bèkuar kloft i madh'in'Zot per hére, nani è gjithë mone per jète te jétevèt. Amin.

Levdi, paçè, i madh'in'Zot paçè levdi. Rrègji i kjièllies çe na pergezton, Shpirti i se vertétiès çe jé gjithasajten, é çe mbush gjithë kjish jane, vistari i se miravèt çe gjélle dhu-ron, éja é rri mè né: pastrona nga çedo mekate, è ruana, o i Mireth, shpирterat t'ane.

O i shéjti Pèrendi, i shéjt i fukjishem, i shéjt i pa-vdékshim, lipisi per né (*tri hére*).

Levdi paste Ati, Biri è Shpirti Shéjt, nani é gjithë mone per jète te jétevèt. Amin.

Trini gjithë è shéjtè, paçè lipisi per né; o Zot, ijna afer tè mekatet t'ona; o i Zot, na ndejé fajète t'ane, Éja, o i Shéjt, é na shendosh ligeshtin t'æne paj te émerit t'it. Lipisi, lipisi, o Zot, paçè lipisi. Levdi past... Ati jine çe jé ne kjièll, klofte shéjteruar émeri jit; jarshit rrègjeria jotè; u bæfte vul-limi jit si ne kjièll, ashtu ne dhé. Buken t'æne te perditshmè æna névè sot; ndejéna detyrete t'ona, si na ja ndejéjem de-teruamvèt t'ane; mos na lé te bièm nde ngariè, po lirona nga i ligu.

Psé jotia æshte rrègjeria è pushtëtia é levdia è t'Jatit,

é te Birit, é Shpirtit Shéjt, nani é gjithë mone è per jéte te jétevèt. Amin.

Diak. é priŕti (nde kshill): Lipisi, o Zot, paçè lipisi per né; psé na tuè klene pa çedo mbrojtìè, Tyj parakjitejem kete lutìè na te mekatruame Tyj si i Zoti çe jé: kijna lipisi.

Levdi paste Ati, Biri, é Shpirti Shéjt.

Paçè per né lipisi, o Zot, psé tèk ti na kémi shperésen: mos u mbri téper mè né, mos u kujto paligjèshit s'ane; por na kekjyr èdhé nani si i but, è na liro nga armikjte t'ane: psé ti jé Pèrendia jine, é na jémi populli jít: te gjithë jémi te bæmè te duarvèt t'otè é na po therésiem émerin t'aent.

É nani è gjithë mone per jéte te jétevète. Amin.

Sbyllna déren è perdeljimit ti, è lumè Mæme è Pèrendis: tèk ti shperèsojem mos te jémi perzæne ;mè tyj dot'jémi liruar nde rrezikjè, psé ti jé shelbésa è te kreshtërevèt.

Fitiren t'aendè, o i Mireth, na ponisiem tuè lipur nde-ljésen è fajvèt t'ane, o Zoti Krisht Pèrendi, psé ti dèshè vét veti t'ishè mè kurmin viérre mbe krykj, sa te na lirojè nga roberia è armikut. Andai tuè dhene hir tyj po therésiem: Na mbushè te gjithë mè haré, o shpetonjesi jine, posa jérdhè te lirojè jéten.

O zonja Mæme è Pèrendis, ti çe jé krua lipisijè, dafshè te ndièsh èdhé per né mishire: verréj popullin te mekatruam, defto, si per hére, pushtëtièn t'aendè: psé mè shperésen tèk ti, na po te thomi tyj: Te falèmi, o Meri, si nje hére Gavrilli, krye i ushteris te kjièllies.

O Zot, ndéj doren t'aendè se larti nga vendi ku ti ndénj, é ipme fukji (me nfortso) të kejo diakeri jotè, sa perpara thèrorès s'atè te drèruashmè pa te kjertuam u mende te mbaronj flijen te papergjakeshmè. Psé jotia æ fukjia é levdia per jéte te jétevèt. Amin.

(S. V. 3) U dua te hinj të shtëpia jotë, dua te premisë tuë u falur të faltoreja jotë më trembesiren t'ëndë.

Bëkuar klofte Përendia jine per hère nani ë gjithë mone é per jéte te jétevèt. Amin.

(Is. LXI. 10) Ka te gezonète shpirti im tèk in'Zot: sé Ai me peshtroi mé te vëshuren ë shendétiës, é me peshtolli më mendilin ë deréjteris: si nji dhëndërri me vu kuroren, si nje nusè me stolisi më bukuri, per hère, nani é gjithë mone...

(Es. XV. 6) È diatheta jotë, o Zot, u levderua ne mändië: ë diatheta jotë, o Zot, dremoi armikjte.

Èdhé të madheria jotë ë larte ti prishë gjithë ata çë vun balle më tyj, per hère...

(S. CXVIII. 73) Me bæn é me gjëshen duarte t'otë: æm ti ndelgim é u kam te dzœ urdhurimete t'ate, per hère...

(S. CXXXII. 2) Bëkuar klofte Përendia çë dérth hirète ë vét mbi prifterat ë tije, si vaj éresh mbi kryèt, çë kullon mbi miékerren, miékerren ë Aaronit, çë rriéth njër të pelkjiri i se vëshures tije, per hère...

(S. XVII. 33) Bëkuar klofte Përendia çë me rrèthoi, më fukji é me bæ te tære pa kjertim udhen t'imè, per hère...

(S. XLIV. 4. 5. 6) Vær rréth mb'ije shpaten t'ëndë, o i mændem. Më hjén t'ëndë é më bukurin t'ëndë, é ndjë harkun, shko perpara, perparo é rrégjero. Paje te se ver-tétiës é te butesis é te deréjteris: vépera te bindeshmë ka te te msonje ë diatheta jotë.

(S. CXXXI) Prifterat t'ate, o Zot, kane te vishèn me deréj-teri; é më shéjterate t'ate kane te gezonèn, per hère...

(S. XXV. 5-12) Dua te lanj duarte t'imè nder te pafaje: é dua vétë rréth thërorës s'atë, sa te bæn j te gjégjèn zærin ë

levdis, è te rrefyènj gjithë thagmete t'otè. U kujdèsèm, o Zot, mbi bukurin è shtepis s'atè é mbi vëndin tëku mbètète levdia jotè.

Mos me prish bashke mé te mekatruamite shpirtin t'im, as mè nijézeze gjakerash gjëllen t'imè. Tè duarte è 'tirè æshte è kékjia, è plote mé te dhæna æshte è diatheta è 'tirè. Por u jétsa pa te kékjite: ti lirome, kijme lipisi; psé kæmba imè u mba mbe udhe te deréjtè: dua te bèkonj tij, o Zot, nde te mbeljédhurate.

PARAVUMIA

Nga næma è ligjes na shperblévè mè gjakun t'ænt te çmuam: ti, o Zot, mè gozhda i viérre, mè shtize i shpuar na prurè njerzévèt pa-vdékjèn: o shpetonjesi jine, paçè levdi.

Bèkuar klofte Pèrendia jine per hére, nani è gjithë mone é per jète te jétevèt. Amin.

Per kujtim t'Iisu Krishtit Zot é Pèrendi é shpetonjesi jine.

(Is. LIII. 7. 8) Si nje délè klé kjëllur per te thértur,

é si kjénkj i pa-faj perpara atij çe è kjéth, i pa zæ, ashtu nuke sbyll gojen è tij.

Nde te pervutite è 'ti, gjikimi i 'tij klé ngréjtur:
è jinin è 'tij kush do t'è rrefyènj?

Priifti: Ngré, urata jotè.

Diak.: Psé klé ngréjtur nga dhéu gjëlla è 'tije.

Priifti: Flijonète kjéngjii i Pèrendis ,ai çe ndsièr mekaten è jétes, per gjëllen é shendétne è jétes.

(Jn. XIX. 34) É nje nga ushtarete mè shtizen i shpoi brinjen è 'ti, è duall nji hérièe gjak é uje.

Per ndër é kujtim te Zonjes s'ane Povirgjere è Shen Meri è bèkuamè, è levduashmè Mæma è Pèrendis: per ane te 'saj, o Zot, prite mè hir ketæ flije mbi thèrorèn t'ændè.

(S. XLIV. 10) Tèk è diatheta jotè rri Rrègjerèsha, è véshure mè ar, gjithe è stolismè.

Per shen Janin profète, te ndërshmin é te te levduashmin Paradrom é Pagezor.

Per shéjterat te levduashme profétera Moyséu é Aaroni, Iliu é Éliséu, Davidhi i Jèséut, é per tré djélmete shéjtera é per Daniélin profète é per gjithe shéjterat profète.

Per shen Piétrin é shen Palin apostoje te levduashme, é te perméndeshme, è per gjithe shéjterat apostoje.

Per te madhin shen Vasij, per shen Grigoriin thèologe è per shen Janin Gojart, per shen Athanasin é per shen Kji-rilin, per shen Kollin te Mires, shéjtera keta, nder aterat shéj-tera, Miéshtera te mbedhénje te botes é jèrarkje é per gjithe shéjterat jèrarkje.

Per te parin dèshmor é arkjiidiaker shen Shtiéfnin, é per dèshmoret te mbedhénje shen Mitrin, shen Gjergjin, shen Thèodhorin é per te gjithe é te gjitha shéjterat dèshmore.

Per thèoforet aterat t'ane shen Ndoni, shen Eftthimi, shen Sava, shen Nufri, shen Athanasi i Athos é per te gjithe é te gjitha shéjtera kallogjère é kallogjerèsha.

Per te thagmebàresete anargjire shen Kosmeni é shen Da-miani, shen Kjiri é shen Jani, shen Pantèléimoni, é shen Ermolau é per gjithe shéjterat anargjire.

Per gjisherat è Pèrendis shéjtera é te deréite: shen Ja-kini é shéitè Ana, per shéjtin (è dites) é per gjithe shéjterat, pr'ane te çilevèt, ti na kekjyr, o Pèrendi.

É nder aterat shéjte t'ane per shen Janin Gojart arkji-péshkepi i Kostantinopulit.

O Zot i dashamire mè né, kujtou per gjithë ipëshkepin mè bésen è deréjtè, per ipëshkepin (aktsilin) t'áne, per te ndérshmèn prifteri é diakeri të Krishti, per gjithë urdnueret jèratike, é per gjithë ata çe mè né jane të sherbésa: prifteria, diakeria é gjithë vellazeria jone, çe ti sglodhè te kén piése mè tyj, per lipisin t'ændè, o i Zot gjith'i mire.

Per kujtim é ndejése é mekatevèt te te lumevèt stisore te kesaj Klishè se shéjtè.

É per gjithë ata atera é vellézere t'ane ne bése te deréjtè, çe u kjelluan gjumi mè shperése të t'ngjallurit te gjëlles pasosmè é të piëstaria jotè, o Zot, i dashamire mè njëziti.

Kujtou, o Zot, èdhé per mua te pavéjefshim é me fal çedo faj mè hir é pa hir.

Tij, o Zoti Krisht Pèrendia jine te faliem livanin per te bukuren ére te shpirtit, çe ti dot è prètsh të thëroreja jotè kjiëllishtè é te na kthësh névè hirète è shpirtit t'it gjithë shéjt.

(Mt. II. 9) É ylli jérdhi é u mba atié siper ku ish dialethi.

(S. XCII. 1) Pèrendia rrègjeron: u peshtua mè madheshti, u ngjësh, u rrèthua mè fukji.

(Abk. III. 2) Virytia jotè, o Zoti Krisht, mbeloi kjiëlliate; é levdiyet s'otè æ plot dhéu.

Peshtrona nën hjés se krahevèt t'ate: réshtë se llargu nësh çedo armik a kundreshtor: æna pakjiè, o Zot, gjëlles s'ane; lipisi paçè per né èdhé jétes s'atè: é sé jé i mire é dashamire, na shpeto shpirtirat t'ane.

Prifti: Bèkuar klofte Pèrendia jine kuj keshtu i pelkjéu. Levdi paçè.

Diak.: per hére, nani é gjithë mone... (tri hére).

Diak.: Mbi te paravumièn è dhurètijvèt te çmuamè t'i lutémi t'in'Zoti.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Prišti: O Pèrendi Pèrendia jine çe Buken è kjiëllies per te ngrene gjithe jétes ti dregovè t'æn'Zone Iisu Krishtin Shpetonjes é Shperblés é mirebæres çe névè bèkon é na shèjteron, ti bèko kete paravumiè persa jé i mire é dashamire mè né, kujtou per ata çe t'è falen, é per kæ ata è prun (è para-kjiten); é névè na ruaj te pandëshkim tè sherbésa shéjte e mistérevèt t'ate te pèrendishme.

Psè u shéjterua é u levderua gjithe i ndérshmi é i maderuashmi émeri jit i t'Jatit, i t'Birit é i Shpirtit shéjt; nani é gjithe mone é per jéte te jétevèt. Amin.

Levdi, o Zoti Krisht shperésa jone, paçè levdi.

Levdi paste...

Lipisi, o i madh'in'Zot. Bèko, urata.

Nder shéjtera i perméndeshim i vertéti Krisht Pèrendia jine, paj te povirgjeres è shen Meri, è delira Mæma è 'tij é paj te Atit shéjt shen Janit Gojart, arkjipëshkepi i Kostantinopulit, é paj gjithe shéjteravèt, na paçit lipisi é na shpetofte si i mire é dashamire. Amin.

Ijme afer, o Pèrendi, lipisi per mua sé jam i mekatruam (tri hére).

Rrégji i kjiëllies çe na pergezón, Shpirti i se vertétiès çe jé gjithasajten, è çe mbush gjithe kjish jane, vistari i se miravèt çe gjélle dhuron, éja é rri mè né: pastrona nga çedo mekate, é ruana, i Mireth, shpirtirat t'ane.

Levdi paste Pèrendia tèk i larti kjiëll é pakjie patshine mbi dhét njérezit mè te mire dashiè.

Me sbyll, o Pèrendi, buzete t'imè, é goja imè ka te rrefiënje levdin t'ændè.

(S. CXVIII, 126) Érdhi héra per te bæmen Pèrendis. Bèko, zoteria jotè.

Bèkuare klofte Pèrendia per hére, nani é gjithe mone per jéte te jétevèt. Amin.

Diak.: Lutu per mua, o zot.

Priſti: Pèrendia i madh'inZot te ndrèkjshite udhete t'otè per çedo bæmè te mire.

Diak.: Kujtou, o zot, per mua.

Priſti: U kujtofte in'Zot Pèrendi per tij tè rrègjeria è 'tij per hére nani é gjithë mone per jéte te jétevèt. Amin.

Diak (nde kshill): O Zot me sbyll buzete t'imè é goja imè ka te rrefiënje levdin t'ænè.

M E S H A

Diak. (me zæ) Bèko, zoteria jotè. Urata jotè.

Prihti: È bèkuamè klofte rrègjeria è t'Jatit, è t'Birit, é Shpirtit Shénjt, nani é gjithë mone per jète te jétevèt.
Amin.

Diak.: N'pakjiè t'in'Zoti duam t'i lipisèmi.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Per pakjièn se larti é per shendétièn è shpirtèravèt t'ane t'in'Zoti duam t'i lipisèmi.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Per pakjièn è gjithë jétes tære é per kjindrésen è klishevèt shéjtè te Pèrendis, è sa te gjitha nje te jén, t'in'Zoti duam t'i lipisèmi.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Per ketæ shtepi te shéjtè è per gjithë ata çë ketu hijen mè bése mè poni mè trembesiren è Pèrendis, t'in'Zoti duam t'i lipisèmi.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Per arkjipëshkepin t'æne, per te ndërshmèn prif-teri é diakeri tè Krishti, per gjithë klérin dhé popullin, t'in'Zoti duam t'i lipisèmi.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Per rrégjin é rregjerëshen te pershpirtçmite é te ruajtore nga Pèrendia, per shtepin è 'tirè, pe shtepin é kjevarin é ushterin è 'tirè mè pakjiè se larti të Pèrendia, t'in'Zoti duam t'i lipisèmi.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Per horezen t'æne é t'Arberëshevèt, per nga kjtët èdhé hore é per gjithë ata çë i jésien mè bése, t'in'Zoti duam t'i lipisèmi.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Per motin è mire, per burin è pémevèt te dhéut é per motèt mè pakjën è Pèrendis, t'in'Zoti duam t'i lipisèmi.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Per ata çë jane é lundrojen, per ata çë jane é jét-sejen, per ata çë jane te semure, çë jane é rièjen, per ata çë jane robe é per shendétièn è tirè, t'in'Zoti duam t'i lipisèmi.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Sa te na ruanje nga tçedo hélmè, mberi, rrezikjè, mièri, t'in'Zoti duam t'i lipisèmi.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Éja, ndihna, shèlbona, kij lipisi, é na ruaj, o Pèrendi, mè dhuraten t'ændè. *burin t'æut*

Lipisi, i madh'in'Zot.

Tuè permëndure Zonjen po Virgjere Mæmen è t'in'Zoti Pèrendi, shen Merin gjithë shéjte, te delirshmè, t'bèkuamè dhè te levduashmè bashke mè gjithë shéjterat, na njéri mè t'jéterin gjithë gjèllen t'æne se bashku i trua-jem Zotit Krisht Pèrendi.

Tij, i madh'in'Zot.

Psè nga levdi, nga ndër é te pernisure te perkét tij
Atit é Birit é Shpirtit shéjt, per hére, nani é gjithë mo-
ne per jéte te jétevé.

Amin.

Lutiè è priftit (nde kshill)

O Zoti jine Pèrendi mè pushtëtiè te pa-krahasuarshmè
ti ké levdin è pa mase, dashurin è pa rrefièshmè per njérsit,
ti vét, Zot é i Zot, per sa æshte butesia jotè, shtié mbi né
siun t'ænt é mbi ketæ shtepi te shéjte: bæn sé te na vinjen te
shuma lipisit t'otè mbi né é mbi ata çe mè né te lutèn, sa te
kémi perdeljésate t'otè.

Antifona I (S. XCI. 2. 3. 16)

Bukur æshte te levdojem t'en'Zone; te mesaliem
émberin t'ænt, o i larti Pèrendi.

Paj te shen Meris Mæma è Pèrendis, shpetonjes,
ti shpetona.

Sa te rrefiejem mènarnèt lipisin t'ændè é natnèt te
vertèten t'ænde.

Sé i deréjt æshte in'Zot Pèrendia im, é tèk Ai mos-
gjæ nhodhète pa te deréjte.

Levdi paste Ati, Biri, Shpirti Shéjt, é nani è gjithë
mone per jéte te jétevé. Ashtu klofte. **Paj te shen Meris.**

Diak.: Perape é perseri n'pakjiè t'in'Zoti duam t'i li-
pisemi.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Éja ndihna, na shëlbo, kij lipisi, é na ruaj, o Pè-
rendi, mè dhuraten t'ændè.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Tuè permëndure Zonjen po Virgjere Mæmen è

t'in'Zoti Pèrendi, shen Merin gjithë shéjtè, te delirshmè, te bèkuamè dhé te levduashmè bashke mè gjithë shéj-terat, na njëri mè t'jétrin gjithë gjëllen t'æne se bashku i truajem Zotit Krisht Pèrendi.

Tij, i madh'in'Zot.

Psé jotia æ pushtëtia, si ëdhé rrègjëria é fukjia é levdia è t'Jatit te Birit è Shpirtit Séjt, nani é gjithë mone é per jéte te jétevèt. Ashtu klofte.

Lutiè è priëtit (nde kshill)

O Pèrendi i madh'in'Zot, shpeto popullin t'ænt, è beko trazhgimin t'ænt, ruaj plotesin è Klishes s'atè, shéjtero ata çë duan ndëriën è shtepis s'atè: ti jipi levdi mè fukjin t'ændè te pèrendishmè, é mos i lesho ata çë tèk ti vun shpë-résen .

Antifona II (S. XCII. 1. 2. 3)

Pèrendia rrègjeron: u peshtrua mè madheshti, u ngjésh, u rrèthua mè fukji.

per part Paj te shéjteravèt t'ate, na shelbo, o i madh'in'Zot.

É keshtu jétes dhéut i dha kjendrése, é s'do tun-déte, s'do taksète.

Dèshmimète t'ate jane shume te béseme: Shtepis s'atè i perkét shéjteria, o Pèrendi, per ditete te glata.

Levdi paste... Paj te shéjteravèt...

Nani é gjithë mone é per jéte te jétevèt Amin.

O i Biri i vétëmi lér é Fiala è Pèrendis, i pavdékshim çë per shendétiën t'æne déshè te mirriè kurm të Povirgjera è Shen Meri Mæma è t'in'Zoti Pèrendi ti pa u nderruare u njërezovè, o Zoti Krisht, Pèrendi, klévè væne n'krikj é tuè vdékure shkélè mortien, Ti nje i Shéjtès Trini, i perlevduam bashke mè Atin é mè Shpirtin shéjt, névè shèlbona.

Diak.: Perape é perseri n'pakjiè t'in'Zoti duam t'i lipisèmi.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Éja ndihna, na shëlbo, kij lipisi, é na ruaj, Pèrendi, mè dhuraten t'ænde.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Tuè permëndure Zonjen po Virgjere Mæmen è t'in'Zoti Pèrendi, shen Merin gjithë shéjtè, te delirshmè, te bèkuamè dhé te levduashmè bashke mè gjithë shéjterat, na njëri mè t'jéterin gjithë gjëllen t'æne se bashku i truaime Zotit Krisht Pèrendi.

Tij, i madh'in'Zot.

Psé, Ti, Pèrendi, jé i mire é dashamire mè njërezit, é na te faliem levdin Atit é Birit é Shpirtit Shéjt, nani é gjithë mone per jéte te jétevé. Amin.

Lutiè è priftit (nde kshill)

O i madh'in'Zot, ti çe mè-hir na dhé te benjem keto lutiè bashke è mè gjithë nje zæ, ti çe na thé sé èdhé mè-hir prêt çedo dy a tré véte væne bashke tij te lipien mbi émberin t'ænt. Ti vét mbaro nani per te miren t'æne lipiète è te bésmevèt t'ate, sa te kémi njohièn è se vertétes tè kejo è pran gjëllen è pasosmè tè jatera jéte.

Antifona III (S. XCIV)

Éjani te gezonèmi tèk in'Zot: ngræjme zærin (mè hajdhi) t'in'Zoti Pèrendi, shëlbésa jone.

Na shpeto, o i Biri i Pèrendis (i ngjalluri se vdëkurish - nder shéjtera fort i permëncem) névè çe te msaliem Alliluja.

Tuè levduar i parakjitèmi é tuè gezuare mè kënka perpara levdis 'tij. Persé in'Zot æ Pèrendi i math è Rrékj i math mbi gjithë dhéun.

Sè i Zoti nënge debon popullin è tij, psé ka tè dora è tije te thëllate è dhéut, é majete è malevét jane te tijate.

I tiji æshte déjti, é Ai è beri : é duarte è tija gjéshen te térmite.

Diak: t'i lutèmi t'in'Zoti. Lipisi, i madh'in'Zot.

Prifti (nde kshill): O Zot é i Zot Pèrendia jine, ti çe tè kjiël-lia vurè urdherè é ushteri ængjejish é arkængjejish per te sherbière levdin t'ænde, ti keshtu èdhé bæen sè bashke mè né te hijen ængjejite shéite, sa èdhé bashke mè né te sher-bejen levdin t'ændè. Psé nga levdi, nga ndër é te permisure te perkét tij, Atit é Birit é Shpirtit shéjt, per hére, nani é gjithë mone per jéte te jétevét. Amin.

Diak: Bèko, zoteria jotè, te hijturite shéjte.

Prifti: Bekuare klofte te hijturite è shéjteravèt t'ate, per hére, nani é gjithë mone per jéte te jétevét. Amin.

H I R I A E V O G E L E

Diak.: Dièja (ngræhèmi) èhtuara.

Éjani t'i falèmi é t'i permisèmi Zotit Krisht Pè-rendi. Na shpeto, o i Biri i Pèrendis (i ngjalluri se vdé-kurish - nder shéjtera fort i perméntshmi) névè çe te msaliem Aliluja.

Diak. (mè zæ): T'in'Zoti Pèrendi duam t'i lipisèmi.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Diak. (nde kshill priftit): Bèko, zoteria jotè, héren è kænkes trishéjtè.

Prifti (tuè bèkuare - mè zæ): Psé ti jé i shéjt, o i Zoti Pè-

rendia jine, è na te japiem levdi tij, Atit é Birit é Shpirtit Shéit, nani é gjithë mone.

Diak. (mè zæ): è per jéte te jétevèt. Amin.

Lutiè è priftit mbi kænken trishéjtè

O i shéjti Pèrendi, ti çe jés è præhè mè shéjterat, ti çe jé kenduare nga Sèrafimte mè kænken trishéjtè é jé perlevduare nga Hjèrëvimte, è jé perfalure premiste nga gjithë fukjite é kjiëllies, ti çe nga mosgjeja holkjè per te klene te gjithë çedo jane, ti çe gjëshè njèrium si fityra jotè sa te te glisie é çe è stolisë mè hirète t'ate, ti çe ép urtesi é ndelgim kuj t'è lip, èdhé nuke debon te mekatruamin, por i dhé pendésè per shendète: ti çe déshè mè-hir névè ketu tè kejo hére t'ishim perpara levdis thèrorès s'atè, sé na te miéret te dhænete t'ate, te t'biëm tij detyren è te permisurit èdhé te perlevdimit, si tij te perkét.

Ti vét, o i Zoti Pèrendi, èdhé nga goja jone mirrè kete kænke trishéjtè nga na te mekatruame, é mè miresin t'ændè kthéji siun lipisiar: na ndejéj névè çedo fajë te bæme mè-hir é pa-hir; shéjterona shpirtërat èdhé kurmete t'ane, é na dhuro sé te te shérbéjem shèjterisht gjithë ditete è gjëlles s'ane: paj te Mæmes è Pèrendis èdhé paj te gjithë shéjteravèt, çe moti tij pelkiyëshme.

Psé ti jé i shéjt, o i Zoti Pèrendi, é na te japiem levdi tij Atit é Birit é Shpirtit Shéit, nani é gjithë mone, é per jéte te jétevèt. Amin.

Pop.: O i shéjti Pèrendi, i shéjt i fukjishem, i shéjt i pavidékshim, lipisi per né.

Diak. (nde kshell): Urdhero, zoteria jotè.

Prifti (nde kshell): Bèkuare klofte ai çe vién n'émber te t'in'Zoti.

Diak. (nde kshell): Bèko, zoteria jotè, thronin è lartshim.

Priſti (nde kshill): I bèkuam jé ti, i madh'in'Zot, çe rri mbi thronin è levdis tè rrègjeria jotè mbi Hjèruvimte per hère nani é gjithe mone per jéte te jétevèt. Amin.

Diak. (me zæ): Vumii 'ré, Dièja, vumii 'ré.

Zglédhesi: Te paravumite è Profétit David, mè zærin...

Diak. (me zæ): Dièja.

Zglédh.: Te shen Palit piése è léteres derguare...

Diak. (me zæ): Po gjégjèmi.

Priſti (nde kshill): Patçe pakjièn ti çe zglohdhè èdhé gjithe populli.

Aliluja (mè zæ).

Lutiè è priſtit (nde kshill) pare sè te zglidhèt Vangjéji shéjt.

O i madh'in'Zot, i mireth mè njérezit, bæn sé te shkel-kjénje tè zemerat t'ona drita è thiièlle per te njohur hjyinin t'ænè; é na sbyll syte è méndiës s'ane per te ndelguare é mèjtuar ligjirimin è Vangjéjit shéit, é na jip trembesyren è urdhurimèvèt t'ate te lume: akje sa tuè shkélure dishirète è kurmit, na mende ruajem detyrete è shpirit, tuè mènduare é tuè véperuare gjithe atè çe tij te pelkjén. Psé ti jé, o Zoti Krisht Pèrendi, te shéjteruamite é te ndriturite te shpiteravèt é te kurmevèt t'ane, é na te japiem levdin tij, Atit, Birit é Shpirtit Shéjt, nani è gjithe mone é per jéte te jétevèt. Amin.

Diak (nde kshill): Bèko, zoteria jotè, ligjironjesine è Apostollit Ungjijtar, te levduashmit (shen Matthé, shen Luke, shen Mark, shen Jan).

Priſti (nde kshill): Pèrendia, i madh'in'Zot, mè lusin è Apostollit Ungjijtar, te levduashmit... tij, ligjironjes te dhæfshit fialen è mændemè sa te mbaronète Vangjéji i te dashurit Bir tij, t'in'Zoti Iisu Krishtit.

Diak. Amin.

Prifti (mè zæ): Dièja. Ngræhèmi shtuara te gjégjèmi Vangjéjin shéjt Pakjièn patshit ju te gjithë.

Pop. Èdhè shpirti jit.

Diak. (me zæ): Si shkruan (shen Mathéu, shen Marku, shen Leka, shen Jani) piése è Vangjéjit shéjt.

Pop. Levdi, i madh'in'Zot, paçe levdi.

Prifti Vumii 'ré, gjégjèmi.

Diak.: Nd'at mot...

Te bésmite (mè zæ): Levdi, i madh'in'Zot patshè levdi. Shume viète patshè, urata jotè. Ty

Diak. (me zæ): Te gjithë po thomi mè gjithë zëmere é mè gjithë mëndièn t'æne se bashku po thomi.

Lipisi, lipisi, i madh'in'Zot, patshè lipisi.

O i Zoti i gjithemendem, Pèrendia i prinderavèt t'ane, gjégjèna, te lutèmi, patshè lipisi.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Patshè lipisi per né, o Pèrendi, per sa è madhè æshte lipisia jotè, na gjéki, te lutèmi, patshè lipisi.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Lutiè è priftit (nde kshill)

O i Zot Pèrendia jine, mirrè mè-hir ketæ lutiè te dhézure e't'dhenevèt t'ate te béseme, é patshè per né lipisi per sa te shuma jane lipisit t'otè: na dérth perdeljésate t'otè mbi né é mbi gjithe popullin t'æent, çe rri é prêt ngak Ti burin è lipisivèt t'otè.

Diak. (me zæ): Tè lutèmi, i madh'in'Zot, per Arkjipéshkupin t'æne é per gjithë priflerin.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Te lutëmi ëdhë per vellëzerite t'ane priftera, kallogjërë é per gjithë vellazerin t'ane tëk in'Zot.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Te lutëmi, i madh'in'Zot, sa te bésmite è kesaj kli-shië, te dhænete è Përendis ata patshinë ngak ti lipisi, gjëlle, pakjië, shendëte, shelbése, ndejësen è mekatevèt.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Te lutëmi ëdhë per ata te lume é te permëndeshim çë stisen ketë klishe shëjtë é per gjithë prinderat é vellëzerite t'ane vdëkure çë flæn varzuare ketu é ku-do ndodhëne.

Lipisi, i madh'in'Zot.

É te lutëmi, i madh'in'Zot, ëdhë per te bésmite çë biën kesaj shtepi shëjtë pémete è 'tirë é ndihien é sbukurojen Klishe shëjtë më te mirat è 'tirë, ashtu ëdhë te lutëmi, i madh'in'Zot, për ata çë varzojen te vdëkurite, ata çë msalien é kendojen kënkat shëjtë; ëdhë te lutëmi per gjithë popullin çë ketu ndodhëte é prêt ngak ti, i madh'in'Zot, te medha é te shuma lipisite t'otë.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Priifti (mè zæ): Psé ti jé Përendia i lipisis më njëriun çë do mire, é na te japiem levdi tij, Atit é Birit é Shpirtit Shëjt, nani é gjithë mone é per jëte te jëtevet. Amin.

Diak. (me zæ): É ju katëkumënje, lutij ëdhë ju t'in'Zoti Përendi.

É na te béseme t'i ndihiem, lutemi per katëkumënjte, sa t'i két lipisi Përendia i madh'in'Zot.

Lipisi, i madh'in'Zot.

sa t'i mponje atirè fialen è se vertétiès.

Lipisi, i madh'in'Zot.

sa t'i sbelonje atirè vangjéjin è se deréjtes.

Lipisi, i madh'in'Zot.

sa t'i vunje bashke mè né tè vathi shéjt, tè Klisha shéjte katholikè é apostollikè.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Éja ndihna, na shelbo, kij lipisi é na ruaj, o Pèrendi, mè dhuraten t'ændè.

Lipisi, i madh'in'Zot.

É ju katèkumènje t'in'Zoti ujni kryèt.

Tyj, i madh'in'Zot.

Lutie è priftit per katèkumènje

(*nde kshell*): O Pèrendi i madh'in'Zot, çe jés tèk i larti kjiell, èdhé ké syun mbi te perunjite, ti çe dregovè per shendéten è njerzèvèt te vétmin-lér Birin t'ænt Pèrendi Zotin Iisu Krisht, ti kekjyr te dhenete t'ate katèkumènje çe te u kane perujure, ti priti tè héra è mire te kén rilindièn mè pastren è mekatevèt, mè te véshuren è paprisheris, ti mirri bashke brænda tè Klisha jotè shéjtè katholikè é apostolikè é nmeroí tè shokjéria bashke tèk è zglédhura grigja jotè.

Prifti (me zæ) Sa ata bashke mè né te levdojen émerin t'ænt te gjithendérshmin è te madheruashmin te Jatit, te Birit, te Shpirtit Shéjt, nani e gjithë mone e per jéte te jétevèt. Amin.

(*me zæ*) Sa jini te gjithë katèkumènje nani te dilni (*tri hére*) ju katèkumènje po te dilni, mos te ndodhète ketu èdhé nje. É na te gjithë te bésme perape é perseri t'in'Zoti duam t'i lipisèmi.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Lutiè è priftit (è para) (nde kshill) per te bésmite

Te falèmi ndériès tij, Zot é Pèrendi i pushtétièvèt, sé na bæn te mire nani te parakjitèmi perpara thèrorès s'atè se shéitè, é premiste te læhèmi tè lipisia jotè per mekatete t'ona é per te padijturate è popullit. Ti, o Pèrendi i madh'in'Zot, mirrè me-hir ketæ lutiè é na bæn te mire, sé te t'faliem tij, lutiè lypiè é flijè te papergjakshmè per te gjithë popullin t'ænt é névè, o i larti Pèrendi, névè, çe na vurè tè kejo diakeri bæn mè fukjin é ndihmen è Shpirtit t'it shéit, sé na te mën-de te pa kjertuashem, te pafajshem nde deshmi te delire te vètedijès s'ane te therésiëm tij, i madh'in'Zot, sa te na gjé-gjèsh é te na jèsh i lipisis tèk è madheja butesi jotè.

Diak. (mè zæ): Éja ndihna, na shëlbo, kij lipisi, é na ruaj, o Pèrendi, mè dhuraten t'ændè.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Diak.: Dièja.

Prifti (mè zæ): Psé nga levdi, nga ndér é te premisure te perkét tij, Atit é Birit é Shpirtit Shéjt, nani é gjithë mo-ne é per jéte te jétevèt. Amin.

Diak. (mè zæ): Perape é perseri n'pakjiè t'in'Zoti duam t'i lipisèmi.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Prifti (nde kshill): Perape é mæ shume po te falèmi premi-ste é po te lutèmi, o i mire é i dashamire, sa te kekjyrsh lu-sin t'æne, te na kjerosh é te na delirsh shpirtërat é kurmète t'ane nga çedo ngjolle mishi é shpirti. Ti, o Pèrendi, na bæn hir te parakjitèmi perpara thèrorès s'atè shéitè pa ftésa é pa gjykim. Èdhé atirè çe mè né te lutène, o i madh'in'Zot, ti dhuro perparim gjélliè é bésiè é ndelgimi se shpirti: jipi ati-rè sa per hère te te sherbéjen mè trembesyre, mè dashuri pa

ftësa, pa gjykim, te kën piëse të mistërëte t'ate shéjte é të rrëgjeria jotë ne kjiëll.

Diak. (me zæ): Éja ndihna, na shelbo, kij lipisi é na ruaj, o Pèrendi, mè dhuraten t'ændë.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Diak. (me zæ): Diëja.

Prifti (mè zæ): Sa ashtu te ruajture na per hère nga pushtétia jotë mënde te t'faliem levdin tij, Atit é Birit, é Shpirtit Shéjt, nani è gjithë mone per jéte te jétevét. Amin.

Prifti (nde kshill): Mosnjëri i lidhur mè deshirët mishi é mè pelkjimët ashte i vejéfshim te vinje, te kjasëte, te t'bænje diakeri tij, o Rrëgji i levdis, persé te sherbuarite tij ashte gjæ te math, te drëruashem ëdhë pushtétiëvét te kjiëllies.

Por mbi gjithë, sa ashte dashuria jotë è parrefiëshme ëdhë è pamase mè njërezit ti u bære njëri pa u ndryshuare è pa u nderruare, é dëshë t'ishnjë Kryëprifti jine, é si i Zoti i gjithësis nëvë na lé sherbësen è flijës liturgjike è papergjakshmë.

Por sé tí vétëm, o i madh'in'Zot Pèrendi urdheron të kjiëllia é të dhéu; ti jé kjëllur mbi nje thron hjëruvik, ti i Zoti i Sërafimvét, Rrëgji i Izraëlit, ti vétëm i Shéjt, çë prähë nder shéjterat. Tij andai truhëmi, i vétëmi i mire é i but; verréj mua te mekatruam é te pavejéfshim sherbetuar t'ënt: me delir shpirtin é zëmeren se ndiëmësh se kekja, é mua keshtu véshur mè duraten è prifteris me bæen te zot (mire) te rri, mè fukjin è Shpirtit Shéjt, perpara kesaj triësës s'atë se shéjtë é te bænfli flije tuë shuguruare kurmin t'ënt te delirshme é te shéjt é gjakun t'ënt te çmuam.

Prandai u te kjasëm mè kryët perunjure é tij te lutem: Mos prir fakjiën t'ændë préj mëjë é mos me læsh mbe nj'ane

é te mos me fshish nga numeri i bijvèt t'ate; por ti, i madh' in'Zot, lé mua te mekatruam é te pavejéfschim sherbetuarne t'ænt, sé te te fal tij keto dhurata: psé ti jé çe fal é çe dhuronè, é ti jé dhurata, o i Krisht Pèrendia jine, é ti è perèt mè hir é ti jé é bæné piése gjithvè: na te faliem levdin tij mè Atin t'ænt te perhérsheëm é mè Shpirtin gjitheshéjt é te mire é gjëlledhenes t'ænt, nani é gjithë mone é per jéte te jétevèt. Amin.

Na ketu hjèruvimte mistikjisht tuè çefakjurith
èdhé na Trinis shéjtè gjallsorè trishéjtèn

kænke tuè kenduarith

po læm mbe nj'ane è gjëlles çedo kujdés:

sa te perésiëm Rrégjin

è gjithesis, çe rèthulare vién papare tufa
tufa ængejish. Aliluja.

Diakeri é prifti thone nde kshill két msalm L

Lipisi per mua patshè, o Pèrendi, per sa è madhè æshte butesia jotè; é per sa te shume jane meshirète t'ate: ti fshij te paligjèn t'imè.

Po tære me laj se paligjèt s'imè, é me delir mekatièt s'imè.

Psé u è njoh te paligjèn t'imè, é mekata imè po me æ kundra per hère mua perpara.

Kundra tij vétëm u mekatrova é perpara fakjès s'ate u bæra te kékjèn, sa te daljsh i deréjt mè fialet t'otè é sa te mundesh kur te jësh gjykuare.

Sé shih sé nde te paligièt u u léva èdhé nde mekate mua me zu mæma imè.

Sé shih ti déshè te vertétièn: ti mua me sbelovè t'érshmate é te fshéhurate è urtesis s'atè.

Ti me shterpik mè isopin, è u kam te delirèm: te me lash é u mæ sé bora dot jém sbardhure.

Bæn te gjéggjëm fiale gezimi é haréjè é te perunjete ésh-terat t'ime kane te gezonène.

Fshihè ti fakjèn t'ænde mekateshit s'imè é fshiji te pa-ligjète t'imè.

Me bæn, o Pèrendi, një zëmere te delire nde mua é shpirt te deréjt me perterij brända mua.

Mos me perzæj nga fakjeja jotè é mos hilkj méjè Shpirtin t'ænt te shéjt.

M'u kthéfte haréja è shendétiès s'ate é me mbafshè fort mè shpirt se larti udhetar.

Dua t'i mbesonj udhete t'otè te paligjevèt, é kekjbærésite kane te prirène tèk ti.

Shpetome mekateshit gjaku, o Pèrendi, Pèrendia i shendétiès s'imè: gluha imè ka te levdonje mè gezim deréjterin t'ændè.

O Zot, me sbyll buzete t'imè, é goja imè ka te rrefyènje levdin t'ændè.

Persé ne dashur kishè flije, u t'è kishia dhæne, por ti nuk kenakjè mè olokaustè.

Flije Pèrendis æshte një shpirt i grijtur tuè dhæmbur: nje zëmere te prère èdhé te perunjure Pèrendia nuke è dishpelkjén.

Klofshè i mire, o Pèrendi, mè Sionin tè pelkjimi jit: é te stisène murète è Jèrusalimit.

Ashtu ate hére dot marsh mè hir flijen è derèteris. dhuratate, olokaustète. Athére kane te te bièn vitçera thèrorès s'atè.

HIRIA E MADHE

Diak (nde kshill): Ngré, zoteria jotè.

Prifti (nde kshill): Ngréni duarte t'uaja mbe vendin shéjt é bèkoni t'æn'Zone (S. 33. 2).

Diak. (me zæ): U kujtofte Pèrendia i madh'in'Zot per né te gjithë tè rrègjeria è tjie per hére nani é gjithë mone é per jéte te jétevèt.

Amin.

Prihti (mè zæ): U kujtofte Pèrendia i madh'in'Zot per né te gjithë të rrëgjëria è tije per hère nani é gjithë mone é per jète te jétevèt.

Amin.

Diak priftit: U kujtofte Pèrendia i madh'in'Zot prifte-rijèt s'otè të rrëgjëria è tije per hère...

Prihti diakërit: U kujtofte Pèrendia i madh'in'Zot dia-kerijèt s'otè të rrëgjëria è tije per hère, nani...

I ndërshmi Iozéf — è ndzori nga ai dru — kurmin t'ænt te delire — nde pelhure è peshtuall — mè arome te çemuamè — tèk ai varr i ri i ri è vu mè kujdës te math.

Mè kurmin të nje varr, mè shpirtin ne férr si Pèrendi, të parraisi pra mè një kusar, è mbi thronin ti jé, o Zoti Krisht Pèrendi, bashke mè Atin é mè Shpirtin Shéjt, tuè mbushur te gjitha pa mase.

Një krua gjëlliè, mæ i bukur sè parraisi, mæ i shkel-kjièm sé një vënt rrégji, o Zoti Krisht Pèrendi, æshte varri jít, krua i te ngjallurit t'ane.

Diakeri é prihti (nde kshill): Ate hère kane te te bièn vi-çera thèrorès s'atè.

Prihti diakërit (nde kshill): Kujtou méjè, o vella è shok të sherbésa.

Diak. priftit (nde kshill): U kujtofte Pèrendia i madh'in'Zot nga prifteria jote të rrëgjëria è tije.

Diakeri (nde kshill): Lutu per mua, zoteria jote.

Prihti (nde kshill): Shpirti Shéjt ka te vinje mbi tij, é ver-tutia è te Lartit ka te te hjèsonje (Lk. I. 35).

Diakeri priftit (nde kshill): Shpirti Shéjt ka te jét bashke mè né të diakëria jone gjithë ditete è gjëlles s'ane.

Kujtou méjè, zoteria jotè.

Priſti (nde kshill): U kujtofte Pèrendia i madh'in'Zot të rrëgjeria è tije per hère, nani...

Diak. (me zæ): É te mbarojem t'in'Zoti lusin t'æne.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Per keto dhurètije te çemuamè ketu paravuna t'in'Zoti duam t'i lipisèmi.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Per ketæ shtepi te shéjtè é per gjithë ata çë ketu hijen mè bése, mè poni, mè trembesiren è Pèrendis, t'in'Zoti duam t'i lipisèmi.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Sa te na ruanje nga çedo hélmè, mberi, rrezikjè, mièri, t'in'Zoti, duam t'i lipisèmi.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Priſti nde kshill: O Pèrendi, i madh'in'Zot, i gjithë mendemi, ti vétëm i Shéjt çë prèt mè hir flije levdimi nga ata çë te therésien mè gjithë zëmere, mirrè ketæ lutiè ngak na te mekatruam, é paravujè të thèroreja jotè è shéjtè é na bæen te vejéshime te te faliem tij dhurètijete é flije te pershpirtçemè per mekatet t'ona é per te paditurate è popullit: è bæenna te mire te gjéjem hir perpara fakjiès s'atè, o Pèrendi, te jète è pelkjième flija jone, é mbi né é mbi keto dhurètije ketu te paravune é mbi githe popullin t'ænt te hièsonje Shpirti i mire i hirit t'it.

Diak. (mè zæ): Éja ndihna, na shelbo, kij lipisi é na ruaaj, o Pèrendi, mè dhuraten t'ændè.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Te na shkonje gjithë dita è mbaruamè mæ sè mire, è shéjtè, mè pakjièn é pa mekate, lypmia t'in'Zoti.

Gjégjna, o i mad'in'Zot (æna)

Ængjellin è pakjiès, udhehékjës te bésem, ruanjes i shpíteravèt é i kurmevèt t'ane, te ja lypiem t'in'Zoti.

Gjégjna, i madh'in'Zot.

Ndejésen é falièn è mekatevèt é te fajvèt t'ane te ja lypiem t'in'Zoti.

Gjégjna, i madh'in'Zot.

Te mirate é çedo vején shpíteravèt t'ane, é pakjièn gjithe jétes te ja lypiem t'in'Zoti.

Gjégjna, i madh'in'Zot.

Motin çe na viétète te gjélles s'ane t'è sosiem mè pakjiè è mè pendése te ja lypiem t'in'Zoti.

Gjégjna, i madh'in'Zot.

Si te kreshtëre, te sosurit è gjélles s'ane pa dhæmbiè, pa te kjertuam, ne pakjiè, é mè mbrojtìè te mire perpara gjykjit te drèruarshem, te ja lypiem t'in'Zoti.

Gjégjna, i madh'in'Zot.

Tuè permëndure Zonjen Povirgjere Mæmen è t'ine Zoti Pèrendi, shen Merin gjithe shéjtè, te delirshmè, te bèkuamè dhe te levduashmè bashke mè gjithe shéjterat, na njèri mè t'jéterin gjithe gjéllen t'æne se bashku i truajem Zotit Krisht Pèrendi.

Tij, o i madh'in'Zot.

Prihti (mè zæ): Mè perdejésat è te vétemit lér t'it Biri, mè kæ ti jé bèkuar bashke mè Shpirtin Shéjt te mire, gjallsuar, nani è gjithe mone, é per jéte te jétevèt. Amin.

Pakjièn patshit ju te gjithe.

Populli: Èdhé shpirti jit.

Diak (mè zæ): Duhèmi mire njèri t'jéterin, sa gjithe nji méndiè t'è ligjirojem.

Populli: Na ligjirojem Atin é Birin é Shpirtin Shéjt, Trinin mè nje te klënet te pa ndarshem.

Prifti (nde kshill): (S. XVII. 2. 3) Te dua mireth, o Pèrendi: In'Zot fukjia imè, kjendrësa imè, peshtrimi im, shpetimi im.

Prift é diakeri nder 'ta: Nder né æshte pakjia é klofshit gjithë ditete è gjëlles s'ane.

Diak. (mè zæ): Diërte, ruajme diërte. Mè urtesi, vumi 'ré.

Populli: U kam bése mbe një Pèrendi: Ati i gjithëmëndemi, çe bæri kjiëll é dhé, atë çe dukète é ate çe s'dukète.

É kam bése mbe nje t'æn'Zone Iisu Krishtin Bir te vétëm te lér nga i Jati çe mæ pare sé jétete è jétevét.

Drite nga drita, Pèrendi i vertét nga Pèrendia i vertèt, i lér, jo i bæ, gjithë një te klënite mè te Jatin: pr'ane te tije kléne bære gjithë kjish jane:

Ai çe per né njëreze é per shendétne t'æne u sdrip nga kjiëllia é u mishërua pr'ane te Shpirtit Shéjt é shen Meris Virgjere é u bæ njëri: klé vane n'krikje per né næn Pontsie Pilatit, pesoi mundimè é klé varzuar; è tréta dite u ngjall si thone te Shkruamète: u ngjip të kjiëllia é rri të ana è deréjte è te Jatit.

É ka te vinje te bænje ligje mbi te gjallete é mbi te vdëkurite: rrëgjeria è 'tije nenge ka te sosur.

U kam bése mbe Shpirtin Shéjt, t'ëne Zone çe jep gjélle: Ai rriéth é vién nga i Jati, ponisur é perfalur é proskjinisur bashke mè Atin é mè Birin, si èdhé bashke i perlevduar:

Ai çe foli pr'ane te Proféteravèt.

U kam bése mbe Klishen çe æshte njæ, è shéjtè, katholikè é apostolikè.

U rreféj é dishmonj një Pagezim per ndeljése te mekatevèt: rri é perés te ngjallurite è te vdékurevèt, é gjëllen é jétes se jardheshmè. Amin.

Diak. (mè zæ): Mbétshim mè poni, mbétshim mè trembesire, vumi 'ré te faliem shéjten dhuretije ne pakjiè.

Populli: Meshire pakjiè, flije levdimi.

Priifti (mè zæ): Dhurata è t'in'Zoti Iisu Krishtit, dashuria è Atit Pèrendi, é te marrite piése te Shpirtit Shéjt klofte mè ju te gjithë.

Populli: Èdhé mè shpirtin t'ænt.

Priifti: Se larti mbajem zëmeren.

Populli: È kémi tèk in'Zot.

Priifti: T'i falemi ndériès t'in'Zoti.

Populli: Mire æshte é deréjt t'i premisëmi Atit, Birit é Shpirtit Shéjt, Trinis mè nje te klënite é te pa-ndarshmè.

Priifti (nde kshill): Mire æshte é deréjt tij te te kendojme, te te bèkojme, te te levdojme, te te falèmi ndériès s'atè, te t'premisèmi tij gjithasajten tè çedo vënt te zoteruamit t'ate: persé ti jé Pèrendia i parrefieshme, i pandelguashme, i parshim, i pakapshim: ti jé gjithë mone é po jé gjithë-nje i panderruashme:

Ti é i vétëmi lér Bir jiti é Shpirti Shéjt jiti.

Ti nga mosgjæ te klëni na holkjè mbe te klënit, é te rare pra na ngræjtè per se riu, é tuè vèperuar te gjitha nuk u

ndajtë ngak na ngjére te na kjëllië mbe kjjëll é te na jipië dhurate rrëgjerin t'ændë te ardheshmë.

Per te gjitha keto na tij é t'it Biri te vétemit lér é Shpirtit Shéjt t'itit na falëmi ndériës s'atë per te gjitha çë dim é çë s'dim, te dukura é te sdukura, te bæma te mira névë ngak Ti te pasura.

Na i falëmi ndériës s'atë ëdhë per ketæ diakeri te shéjtë çë na bæn te vejëfshme é perët më hir nga duart t'ona; mbi gjithë sé ketu perpara é rrëth te jane mijera arkængjejjish é mija mijash ængjejjish Hjërvimte é Sërafimte më gjashte flëte më te shuma sira n'airi çë fluturojen:

Priſti (me zæ): É kënken è mundesis tuè kenduar, tuè uluritur, tuè therritur, tuè thene:

Populli: O i Shéjt, o i Shéjt, o i Shéjt Zoti Savaoth (i ushterivët), kjjëlli é dhëu jane te plote më levdin t'ændë; Osanná të mæ i larti kjjëll. I bekuam ai çë viën mbe émbrin è t'in'Zoti. Osanná të mæ i larti kjjëll.

Priſti (nde kshill): É më keto pushtëtië te lumë na, o Zot, o i madh'in'Zot më né i mireth, ëdhë na therésiëm é thomi: I shéjt jé ti è gjithë i shéjt. Ti é Biri jit i vétemi lér é Shpirtit jit i Shéjt. I Shéjt jé é gjithë i Shéjt, é levdia jotë è maddheruashmë. Ti çë dëshë akje mire ketæ jéte, sa na dhé t'æt Bir te vétemin lér, persé mos te sbirëte njëri çë ka bése tëk Ai, por te két gjëlle te pasosmë: I çili kur jërdhi, posa çë mbaroi gjithë urdhurimëte si i duhëj, tëk ajo nate çë klë predhëne, por mæ sé ëdhë vét u dha per gjëllen è gjithësis, mori buken të duart è tija te shéjtë, te delira, te pastera, u fal ndériës, è bëkoi, é shejteroi, é tuè ndajtur ja dha dzene-svèt 'tije te shéjte, apostojvët, tuè thæne:

(mè zæ): MIRNI, HANI: KEJI Æ KURMI I JIM, ÇE PER JU ÇAHËTE PER NDEJËSE TE MEKATEVËT.

Populli: Amin.

(*nde kshill*): Èdhé keshtu mè kjélkjìn, si sosi te ngræni darken, tuè thæne:

(*mè zæ*): PINI NGA KEJI, TE GJITHE: KEJI Æ GJAKU I JIME, TE DHIATES SE RÉ ÇE PER JU È PER SHUME (VÉTE) DÉRDHÈTE PER NDEJÉSE TE MEKATEVET.

Populli: Amin.

Prihti (*nde kshill*): Tuè kujtuare nani ketæ urdhurim te shendétiès é gjithë atæ çë u bæ per né, krykjiën, varrin, te ngjallurite tèk è tréta dite, te hipurite ne kjiëll, é te rrijure mbe thron tèk è deréjta, é te jardhurite se dyjti per se ri te levduashim.

(*mè zæ*): Na tij te faliem t'otète nga t'otète per te gjitha é mbi te gjitha.

Populli: Tij na levdojme, Tij na bèkojme, Tij falèmi ndériès s'atè, o Zot, é Tij lutèmi, o Pèrendia jine.

Prihti (*nde kshill*): Èdhé te faliem Tij ketæ flije te ménçemè, é te papergjakeshmè; é na te truaime, te lipisèmi, te lutèmi: Drego Shpirtin t'ænt te Shéjt mbi né é mbi keto dhuretije te paravumè.

Prihti é Diak. (*nde kshill*): O Zot, ti çë tèk è tréta ore dregovè mbi apostojit Shpirtin t'ænt te gjitheshéjt, ketæ, o i mirèth, mos na è rrésht, por na è perterij névè çë te lutèmi.

(S. L. 12) Me bæen nje zëmere te delire nde mua é shpirt te deréjt me perterij brènda mua.

(S. L. 13) Mos me perzæj nga fakjeja jotè é mos hilkej méjè Shpirtin t'ænt te Shéjt.

Diak priftit (*nde kshill*): Bèko, zoteria jotè, Buken è shéjtè.

Priſti (nde kshill): È bæn ketæ buke, kurm, te çmuam te Krishtit. Amin.

Diak. priſtit (nde kshill): Bèko, zoteria jotè, kjèlkjin è shéjt.

Priſti (nde kshill): Dhé atæ çe æ tè kjèlkj i Shéjt, gjakun è çemuam te Krishtit. Amin.

Diak. priſti (nde kshill): Bèko, zoteria jotè keta te dy bashke.

Priſti (nde kshill): Tuè i nderruare mè Shpirtin t'ænt te Shéjt. Amin, amin, amin.

Diakeri (nde kshill): Kujtou per mua te mekatruam, zoteria jotè.

Priſti (nde kshill): Sa te jète atyrè çe marrien piése per te lar shpirtin, per te ndejér mekate, per piése te Shpirtit Shéjt per te mbushur rrègjerin è kjièlliavét, per te klene thiésht i béses mè Tij, jo per te gjykuar as per te denuar.

Perape te falieſm Tij ketæ flije te ménçemè per ata çe u præjtin n'bése, prinderat te pare, aterate, patriarkerat, proféterate, apostoſite, ligjironſite, vangjëtarete, deshmorete, rrefénſite, te perkorete, é nga shpirt çe vdikj mè bésen.

Priſti (mè zæ): É vétsh per Mæmen è t'in'Zoti Pèren-di, gjitheshjëjtè, te delirshmè, te bèkuamè dhé te lev-duashmè, Zonjen Povirgjere shen Meri.

Populli: I math æ émeri i Trinis Shéjtè.

Shume mir'isht mè te vertète

sa te thomi tij te lumè Zonje

per gjithë mone t'lumeshmè dhé te paperlyèmè èdhé Mæme te te madhit Zot.

Tyj mæ te ndèroshmè sé hjèruvimte

è pa te perkrahur
 me te levdosshmè sé serafimte
 çe pa farè u ndotur
 te Larten Fiale lindè
 vertéta Mæma t'Zotit
 po madherojem na.

(Giuseppe Schirò)

Prihti (nde kshill): Per shen Janin profète é paradrom é pagezor, per te levduashmit shéjtera apostoje, per shen (aktsilin) çe sot na permëndiem, é per gjithë shéjterat t'ate, paj te çilvèt ti, o Pèrendi i madh'in'Zot, kijna syun; é kujtou per gjithë ata çe u prejtin mè shperésen të te ngjallurite é gjëlles pasosmè.

Per shendétièn é ndejésen è mekatevèt te (aktsilit) sherbetorit t'in'Zoti.

Per te præjturite é ndejésen è mekatevèt te (aktsilit) sherbetorit t'it: o Pèrendi ti jipi præhiè ne vënt dritiè, tèku nænge æshte hélm é rækim: lé te prehète, o Pèrendia jine, atiè ku è ruan drita è fakjiès s'atè.

Te lutèmi èdhé, o Zoti Pèrendi, kujtou per gjithë upèskepin te béses deréjte, çe shpal derékj fialen è vertétiès s'atè; kujtou per gjithë prifterin, per diakerin tèk in'Zot, per gjithë urdherin prifterishte.

Na te faliem ketæ flije te mënçemè te latris èdhé per gjithesin è jétes, per klischen shéjtè katholikè e apostolikè, per gjithë ata çe shkojen gjëllen è delire é te ndérmè, per te bésmi è nga Krishti te dashure rrégjerat t'ane, per gjithë kurten èdhé ushterin è 'tirè; Ti, o Pèrendi, jipi atirè rrégjerin n'pakjiè, sa èdhé na nde te pakjet te 'tirè te shkojem gjëllen te kjétemè é te preret gjithë nde lutesi é mè ndër.

Prihti (mè zæ): Nder te paret kujtou, i madh'in'Zot, per Papen t'æne (aktsilin) kuj ti jipi, te lus, te jét per klisheet t'otè shéjtè i ruajtur, i ndérm, i shendosh, mè dite te glata te shpalnje deréjte fialen è vertétiès s'atè.

Populli: Per te gjithë é te gjitha.

Prifti (nde kshill): Kuitou, i madh'in'Zot, per horen tëku na jésiem, per nga kjitète é hore é katunt é per ata çë atié i jésien n'bése.

Kujtjou, i madh'in'Zot, per ata çë jane é lundrojen, per ata çë jane é jétsien, per ata çë jane te semure, çë jane é rièjen, per ata çë jane robe é per shendétièn è 'tirè.

Kuitou, i madh'in'Zot, per ata te béseme çë bièn kli-shevèt t'otè shéjttè pémete è 'tirè, é ndihien é sbukurojen klishte t'otè shéjttè; é per gjithë ata çë kane kujdés te va-pekjevèt: é mbi gjithë névè ti dérth lipisite t'otè.

Prifti (mè zæ): É te na japsh hir sa gjithë mè një gojë é mè një zëmere te levdojem é te kendojem te gjithen-dérsmin é te madheruarshim émere t'ænt, Tyj Atit é Birit é Shpirtit Shéjtt, nani é gjithë mone é per jéte te jétevèt. Amin.

Prifti (mè zæ): É lipisite è te madhit Pèrendi shèlbo-njesi jine, t'Iisu Krishtit kloffshin mè ju te gjithë.

Édhé mè shpirtin t'ænt.

Diak. (mè zæ): Posa kémi perméndur gjithë shéjterate, perape é perseri n'pakjiè duam t'in'Zoti t'i lipisèmi.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Per te çemuamèt dhuretije te paravumè é te shéj-teruamè t'in'Zoti duam t'i lipisèmi.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Sa Pèrendia jine akjë i mire mè né, çë i mori mè hir mbi shéitèn therorè kjièllishtè te mençmè per te mi-ren ére te pershpirtshmè, nani névè te na dhæfshit kthyèr hirthin te pèrendishim é dhuraten è Shpirtit Shéjtt, t'in'Zoti duam t'i lipisèmi.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Sa te na ruanje nga çedo hélmè, mberi, rrezikjè, mièri, t'in'Zoti duam t'i lipisèmi.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Pristi (nde kshill): Tèk ti, i mireth Zoti Pèrendi, na læm truar tyj gjithë gjëllem t'æne é shperésen t'æne: é te lusiem tue u lipisur, é te lipiem: bæanna ti te mire te marriem piése të keta mistère kjiëllishtè é te drèruarshem te kesaj trièsè shéjtè é te pershpirshmè mè vètdijen te delire per ndejése te mekatevèt, per lirin te fajvèt, per piése te hirvèt te Shpirtit Shéjt, per trazhgim te rrègjeris se kjiëllivèt, per bésen tèk ti, i madh'in'Zot, jo per gjikim, jo per denim.

Diak. (mè zæ): Éja ndihna, na shëlbo, kij lipisi e na ruaj, o Pèrendi, mè dhuraten t'ændè.

Lipisi, i mad'in'Zot.

Te na shkonje gjithë dita è mbaruamè mæ sè mire, è shéjtè, mè pakjièn é pa mekate, lypmia t'in'oZoti.

Gjégjna (æna), o i madh'in'Zot.

Ængjellin pakjiè, udhehékjës te bésem, ruanjes te shpirtavèt é te kurmevèt t'ane te ja lypiem t'in'Zoti.

Gjégjna, i madh'in'Zot.

Ndiése é te liruom te mekatevèt é te fajvèt t'ane, te ja lypiem t'in'Zoti.

Gjégjna, i madh'in'Zot.

Te mirate é çedo vején shpirtavèt t'ane, é pakjiè gjithë jétes, te ja lypiem t'in'Zoti.

Gjégjna, i madh'in'Zot.

Motin çe na viétète, te giëlles s'ane t'é sosiem mè pakjiè é mè pendése, te ja lypiem t'in'Zoti.

Gjégjna, i madh'in'Zot.

Si te kreshtëre, te sosurite è giëlles s'ane pa dhëm-

biè, pa te kjertuam, ne pakjiè, é mè mbrojtìè te mire perpara gjykjit te drèruarshem, te ja lypiem t'in'Zoti.

Gjégjna, i madh'in'Zot.

Pas te lypuri njinin è béses é te marrit piése te Shpirtit Shéjt, na njëri mè t'jéterin se bashku i trujem gjëllen t'æne Zotit Krisht Pèrendi.

Tyj, o i madh'in'Zot.

Prifti (mè zæ): É na bæen te mire, o i madh'in'Zot, sé mè bése te kudzojem pa ftése te te therésiem Tyj 'n se kjiëlli Pèrendi si Tatè é te te thomi:

Ati jine çe jé ne kjiëll, klofte shëjteruar émeri jit; jarshit rrëgjeria jotè; u bæfte vullimi jit si ne kjiëll, ashtu ne dhé.

Buken t'æne te perditshmè æna névè sot; ndejéna detyrete t'ona, si na ja ndejéjem deteruamvét t'ane; mos na lé te biëm nde ngariè, po lirona nga i ligu.

Prifti (mè zæ): Psé jotia æshte rrëgjeria, é fukjia é levdia e t'Jatit, é t'Birit é Shpirtit Shéjt, nani é gjithë mone é per jéte te jétevèt. Amin.

Diak. (mè zæ): Ujni kryèt t'aje t'in'Zoti.

Tyj, i madh'in'Zot.

Prifti (lutiè nde kshill): Te falèmi ndériès s'atè, o rrékj çe s'dukè, por ti bærè é gjëshè te gjitha mè pushtëtien t'ændè te pa mase: ti tè lipisia jotè è plote pa te klène theritè gjithësin nde te klënet. Ti vét, o i madh'in'Zot, se larti kij syun mbi keta çe tyj ujen kryète è 'tyre; psé perujène jo mishit a gjakut, por tyj Pèrendi te drèruashem. Ti andai, i madh'in e Zot, bæen sé keta mistère ktu paravume klofshin per te mire gjithë névè, nga njëriu si i duhèt: lundro bashke mè ata çe

lundrojen, éts ti, i madh'in'Zot, bashke mè udhtarete, shendoshi ti te semurete, ti çe jé miéku i shpirtaravèt é i kurmevèt.

Diak. (mè zæ): Mè dhuraten, mè lipisite é mè miresin çe ka mè né it Bir i vétemi lér, mè kæ ti jé i bekuam bashke mè Shpirtin gjitheshéjt te mire é gjallsuar, nani è gjithë mone, é per jéte te jétevé.

Amin.

Prifti (nde kshill): O Zoti Iisu Krisht Pèrendia jine, kekjyr nga ndénja jotè è shéjtè é nga throni i levdis rrègjeris s'atè, é éja te na shèjterosh, ti çe se larti rri mè Atin é ketu, na pa par, ti mè né ndodhè: é te duash mè doren t'ændè te forte te na japsh kurmin t'ænt te delire é te çemuamin gjak èdhè gjithë popullit per duart t'ona.

Prifti dhé diak. (nde kshill): Ijme afer, o Pèrendi, lipisi per mua, sé jam i mekatruam (tri hére).

Diak. (mè zæ): Vumi 'ré.

Prifti (mè zæ): Te shéjtete shéjteravèt.

Populli: Nje i Shèjti, një Zoti, Iisu Krishti ne levdi te Atit Pèrendi. Amin.

Levdoni t'æn'Zone ju nga kjièllia, levdoniè tè mæ i larti kjiéll.

Diak. priftit (nde kshill): Çajè, zoteria jotè Buken shéjtè.

Prifti (nde kshill): Çahète é bænèt piése piése kjéngji i Pèrendis, i Biri i t'Jatit, i çili çahète, é po nuke ndahète, é gjithë hére hahète po nuke sosète, é è shèjteron kush i mérr piése.

Diak. priftit (nde kshill): Mbushè, zoteria jotè, kjélkjïn shéjt.

Priſti (nde kshill): Plotesia è béses se Shpirtit Shéjt. Amin.

Diak. priſtit (nde kshill): Bèko, zoteria jotè, te nzéhtite.

Priſti (nde kshill): Bèkuare te nzéhtite è shéjteravèt t'ate per hére nani é gjithe mone, é per jéte te jétevèt. Amin.

Diak. (nde kshill): Te nzéhtite è béses, plot mè Shpirt te Shéjt.

Priſti (nde kshill): U kam bése, o Zot, é po thom sé ti jé i Biri i Pèrendis gjalle, çe jérdhè tè jéta sa te shëlbojë te mekatruamite, é u jam i pari i mekatruam.

Tè darka jotè mistikè, o i Biri i Pèrendis, bæn me sot te marr piése èdhé u: psé u mistérin t'ænt s'ja thom armi-kjevèt, as te jap te puthur, si bæri Juda; por si kusari u tyj te thom: Kujtou per mua, o Zot, tè rrégjeria jotè.

O Zot, u s'jam i mire sé ti te hish nen stréhèt te shpirtit t'im; por si durovè te prèhèshè tè nje shpèlle tè grazhdi i shtazevèt é tè shtepia è Simonit te kromosur (gerbulur), é ashtu si pritè mire atë grua te mekatruamè, si jam èdhé u, dafshè ashtu ti vét, o Zot, èdhé te hish tè grazhdi i shpirtit t'im pa mënd é tèk i perlyèmi kurmi jim i vdékur é i gerbulur; si èdhé nuke è rrështè gojen è ndohte te kurves çe te puthi kæmbet è delire t'otè, ashtu, o i Zot, Pèrendia jim, mos me rrësht mua te mekatruam; por si i mire é i dashamire, dafshè sè u te kungonèm mè kurmin t'ænt gjitheshéjt é mè giakun t'ænt.

O Pèrendia jine, ti me zglith, me lesho, ndejéme te rarate t'imè nde mekate per sa te ftésa, tuè njohure é tuè pa njohure, çedo bæra mè te fola é mè te bæmè: te gjitha m'i ndejé, o i mire é i but me né; paj te Povirgjeres Mæmes s'atè te gjithe delire, ti me ruaj pa-kjertuashem si te marr mè hirin t'ænt te çmuamin kurmin t'ænt te delire per shendétiè te shpirtit é te kurmit.

Psé jotia æshte rrégjeria é fukjia é levdia per jéte te jétevèt. Amin.

Mos me klofte per gjykim a per denim keta te marr piése te mistérevèt t'ate shéjtte, por klofte per shendétiè te shpirtit é te kurmit t'im.

Prifti diakerit (nde kshill): Diaker, kjasu.

Diak. priftit (nde kshill): Pa æm, zoteria jotè, te çmuamin kurmin shéit te Zotit Pèrendi Ijsu Krishti, Shelbonjesi jine.

Prifti diakerit (nde kshill): I jipète diakerit (aktsilit) i çmuami kurmi shéjt é i delir te Zotit Pèrendi Iisu Krishtit, shèlbonjesi jine per ndejése te mekatevèt è 'tija é per gjélle te pasosmè. Amin.

Prifti (nde kshill): Èdhé mua prift sherbetuar i pa vejéshim, jipète i çmuami kurmi shéjt é i delir te Zotit Pèrendi Iisu Krishti, shèlbonjesi jine, per ndejése te mekatevèt t'imè é per gjélle te pasosmè. Amin.

Prifti (nde kshill): Prifti sherbetori jit (aktsili) kungonète mè te çmuamin Gjak te Zotit Pèrendi Iisu Krishtit, shèlbonjesi jine.

Ne émer te t'Jatit, te Birit, te Shpirtit Shéjt. Amin.

Prifti diakerit (nde kshill): Diaker, kjasu.

Diakeri (nde kshill): Ketu jam: kjasèm rrègjtit te pavdékshim é Pèrendi jine.

Pa æm, zoteria jotè, te çmuamin Gjak i Shéjt te Zotit Pèrendi Iisu Krishtit, shèlbonjesi jine.

Prifti Diak. (nde kshill): Sherbetori i Pèrendis diakeri (aktsili) kungonète mè te çmuamin Gjak i Shéjt te Zotit Pèrendi Iisu Krishtit, shèlbonjesi jine per ndejése te mekatevèt tija é per gjélle te pasosmè.

Prifti diakerit (nde kshill): Keta ngau buzete t'otè é dot ndziérnje fajète t'ate é kat kjeronje mekatet t'otè (Is. IV. 7).

Lutiè è priftit nde kshill

Te falèmi ndériès s'atè, o i Zoti dashamire, mirebærèsi i shpirtiravèt t'ane, se èdhé tè kejo dite na bærè te mire te kishem piése tè mistèrèt kjiëllishtè é te pavdékshim: ti na ndrèkj udhen t'æne; na mbaj forte te gjithë tè trëmbesyra jotè; na bæn te pashkasurshmè këmbete t'ona paj te lutiè-vèt é te lipievèt è Povirgjeres Shen Meri, te levduashmès Mæme è Pèrendis é paj te gjithë shéjtravèt t'ate.

Diak. (mè zæ): Mè trëmbesiren è Pèrendis, mè bése é mè dashuri te kjasij.

Populli (mè zæ): Amin, amin, amin. I bèkuam ai çe vién mbe émberin è t'in'Zoti: Pèrendi Zot èdhé névè na u deftua.

Prihti (te bésmevèt çe kungonène): Kungonète sherbetori, sherbetoria è Pèrendis, (aktsili, aktsila) mè te çmuamin kurm é gjak te shéjt t'in'Zoti Iisu Krishtit, Pèrendia jine, per ndejésen è mekatevèt é per gjélle te pasomè. Amin.

Prihti (mè zæ): Shelbo, o Pèrendi, popullin t'ænt, é bèkò trazhgimin t'ænt.

Populli (mè zæ): Na pam driten è vertéte, na muartim Shpirtin 'n se kjiëllit, na gjétem bésen è vertéte: tuè u falur premiste Trinis se pa-ndarshmè: psè kejo névè na shelboi.

Prihti (nde kshill): Ngréu lart, o Pèrendi, mbi kjiëlliat é levdia jotè shkelkjéfte mbi gjithë dhéun.

Prihti (nde kshill): Bèkuar klofte Pèrendia jine.

(mè zæ): Per hére, nani é gjithemone, é per jéte te jétevéte. **Amin.**

Diak. (mè zæ): Na çe shtuara (si te shpéjtte) u kémi kunguare mè te pèrendishmit shéjtte mistérè te delire, te pavdékshim, 'n se kjièlli, gjallsore é te drèruashme t'lisu Krishtit, na vejéfshim t'i falèmi ndériès t'in'Zoti.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Éja ndihna, na shèlbo, kij lipisi, é na ruaj, o Pèrendi, mè dhuratën t'ændè.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Na tuè lipur te na shkonje nga dite è mbaruamè mæ sé mire, è shéjtè, mè pakjièn é pa mekate, njëri per t'jéterin gjithë gjéllen t'æne se bashku i truajem Zotit Krisht Pèrendi.

Tyj, i madh'in'Zot.

Prihti (mè zæ): Psé ti jé te shéjteruamite t'ane é na te faliem levdin tyj, Atit é Birit é Shpirtit Shéjtt, nani é gjithë mone è per jéte te jétevèt.

Populli: Amin.

Prihti (mè zæ): É nani vémi mè pakjièn.

Populli: É mè émerin è t'in'Zoti.

Diak. (mè zæ): T'in'Zoti duam t'i lipisèmi.

Lipisi, lipisi, i madh'in'Zot,
paçè lipisi, bèkona, zoteria jotè.

Lutiè prapa ambonit.

Prihti (mè zæ): O i madh'in'Zot, ti çe bèkon ata çe te bekojen, é shéjteron ata çe tèk ti bèsojen, shèlbo popullin t'ænt, é bèko trazhgimin t'ænt.

Plotesin è Klishes s'atè ruaj, shèjtero ata çe duan hjén è shtepis s'atè.

Ti kthéi levdin mè pushtëtièn t'ænde te pèrendishmè, é mos na lé névè çe kémj shperésen tèk ti.

Ti dhuro pakjièn jétes s'atè, klishvét t'otè, prif-teris, rrègjeravèt t'ane, ushteris é gjithë popullit t'it.

Psé nga dhate è mire è nga dhuretije mæ sé è mire vién 'n se larti, sdripète ngak ti Ati i dritevèt; é na te falciem levdin, te falurite ndériès é te premisurite Tyj. Atit é Birit é Shpirtit Shéjt, nani é gjithë mone é per jéte te jétevèt.

Populli: Amin.

Populli: Bèkuare klofte émeri i t'in'Zoti çe nani é njér motè mone. (tri hére).

Prihti (nde kshill): Ti, o Zoti Krisht Pèrendia jine, çe jé mbarimi i ligjes é i proféteravèt é çe mbarovè gjithë urdhurimèt è Atit Pèrendi, ti mbush mè haré é gezim zëmerat t'ona per hére nani é gjithë mone, é per jéte te jétevèt. Amin.

Diak (mè zæ): I lutèmi t'in'Zoti.

Lipisi, i madh'in'Zot.

Prihti (mè zæ): Bèkimi i t'in'Zoti mbi né klofte mè dhuraten é miresin è 'tije per hére nani é gjithë mone é per jéte te jétevèt. Amin.

O è shen Meri, Mæma è t'in'Zoti, névè shpetona.

Populli: Tyj me te ndèroshmè...

Priſti (mè zæ): Levdi patshè, o Pèrendia jine, patshè levdi.

Populli: Levdi paste Ati, Biri é Shpirti Shéjt, nani é gjithë mone é per jéte te jétevèt. Amin. Lipisi, lipisi, i madh'in'Zot, patshè lipisi. Na bèko, zoteria jotè.

Priſti (mè zæ): Zoti Krisht (nder shéjterat i perméndshme — i ngjalluri se vdékurish) i vertéti Pèrendia jine, per ane te Povirgjeres è shen Meri Mæma è t'in'Zoti, è delirshmè, mè virtyten è krikjès shéjtè te çmuamè é gjallsorè, mè mbrojtè te te ndërshmevèt pushtétiè te poshpirtshmè te kjièllies, paj te levduashmit proféte é pris shen Jan pagezor, paj te levduashmevèt shéjtera apoſtoje te perméndeshim, paj te levduashmevèt shéjtera deshmore mundesore, paj te Ateravèt shéjte te Pèrendis è mè ndihmen è gjishravèt è Pèrendis shen Jaki ni é shent'Ana é paj te shen (aktsilit), çe sot perméndiem èdhé te gjite shéjteravèt, Zoti Krisht Pèrendi, i mire è dashamire na shpetofte é mè lipisi na ruashit.

Amin.

Priſti (nde kshill): Lé nani, o i madh'in'Zot, sherbetorin t'ænt, sa te vé ne pakjiè mbi fialen t'ændè, psé è pan syte t'ime Shendétièn t'ændè, çe bærè gati perpara fakjès se gjithë popujvèt: Drite per te ndriturit è gjindevèt, é levdi t'Israélit, popullit t'it. (Lk. II. 29-32).

Si nje flake è ndriti jéten è tære tuè shkelkjièr ai hir i gojes s'atè, o i shen Jan gojarti, ajo goje çe la vistarè è doregjèrësis, é na deſtoi te lartite è perunjësis tuè na msuar mè fiale t'otè: Lutu per ne Iisu Krishtit Pèrendi sa te jén shèlbuar shpirtërat t'ane.

Mè dhuratate çe patè se larti (se kjiellshit) ti, o i shen Jan Gojarti, i mpsovè gjithhevè mè buzete t'otè, si t'i falèmi Pèrendis njij te vétëm ne Trini shéjtè. Na te ndérim, o ati shéjt i lumberuashim, psé ti jé miështer çe ke urtesin è pèrendishmè.

FINITO DI STAMPARE IN PALERMO
NELLA SCUOLA LINTIPOGRAFICA
« BOCCONE DEL POVERO »
I L 2 0 L U G L I O 1 9 6 4

